



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë  
Bachelor “Gjuhë Shqipe dhe Letërsi”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Isamili Qemali”  
Vlorë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:



1. Prof. Dr. Mimoza KORE

2. Dr. Elida BEGAJ

Maj 2021

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**  
**Për Programin e studimit Bachelor në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi ofruar nga**  
**Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Shkresë Nr. 5352 Prot, datë 22.08.2005
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Regjistrimi i formës së diplomës:	UMASR Nr. 439, datë 09.09.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	--
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	15/1
18	Numri i studentëve:	143 studentë
	Komente / të tjera:	-

## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Më 22 dhe 23 dhjetor Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zhvilloi vizitën në Universitetin "I. Qemali" në Vlorë për vlerësimin e programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor "Gjuhë Shqipe dhe Letërsi" (Online). Vlerësimi i këtij program studimi bëhet për herën e parë nga ASCAL-i.

Për të kryer vlerësimin GVJ u mbështet në RVB, bashkëshoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe në takimet me të gjithë aktorët përgjegjës për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e këtij program studimi.

Qe në fillim do të donim të theksonim punën e mirë që është bërë për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë, po të kemi parasysh se është përvoja e parë e këtij departmenti që mbulon këtë program studimi. RVB-ja është ndërtuar në frymë kolegjiale, me objektivitet dhe janë bërë përpjekje që ai të pasqyrojë me vërtetësi gjendjen aktuale të cilësisë së programit të studimit, stafit akademik dhe atij administrativ si dhe të infrastrukturës mbështetëse. RVB-ja është ndërtuar duke përdorur të gjitha burimet e nevojshme, duke e mbështetur çdo pohim në shkresën përkatëse që disponon DGJL si dhe duke përdorur drejt terminologjinë e fushës së vlerësimit të cilësisë.

Programi i studimit është hartuar dhe zbatohet në përputhje me kërkesat e Ligjit të AL 80/2015, të akteve nënligjore dhe të urdhrave e rekomandimeve të Senatit Akademik dhe Rektoratit të UV "I. Qemali".

Disiplinat gjuhësore dhe letrare që përbëjnë këtë program studimi janë planifikuar të ndara me silabuse dhe ngarkesa në ETCS. GVJ vëren se ka vend ende për përmirësim, veçanërisht të raportit të ngarkesës midis disiplinave të formimit bazë dhe disiplinave të tjera. Gjithashtu duhet një ngarkesë më e reduktuar për disa pedagoge, të cilët mbajnë disiplina jo të një natyre dhe të afërta.

DGJL i FShH në Universitetin e Vlorës ka në përbërje staf akademik me përvojë dhe të kualifikuar që i përballon shumë mirë kërkesat shkencore që shtron ky program studimi. Po kështu ka në përbërje profesorë me përvojë akademike dhe pedagogjike që janë mbështetje e madhe për promovimin e më të rinjve. GVJ-ja vërejt se puna shkencore e stafit akademik duhet të jetë më e shtuar gjatë një viti akademik si dhe stafi duhet të përfshihet më shumë në projekte e trajnime ndërkombëtare.

Sfida me e madhe që duhet të zgjidhe në të ardhmen ky departament është tërheqja e më shumë studentëve në këtë program studimi. Aktualisht ka vetëm 7 studentë në vitin e parë, 15 në vitin e dytë dhe 22 në vitin e tretë. Ky është një problem i cili ndërthur shumë arsye dhe aktorë dhe nuk e vuan vetëm ky departament, prandaj si prej UV, si prej fakultetit ku bën pjesë ky departament duhen hartuar politika për të rritur numrin e studentëve.

Megjithëse pas zhvillimit të këtij program studimi, bachelor, studenti i ka të pakta mundësitë e punësimit DGJL si dhe strukturat përkatëse të UV duhet të jenë më në kontakt me të diplomuarit (alumni) dhe të krijojnë databazën për këtë.

## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm**

Pas trajnimit nga specialistë të ASCAL-it, GVJ u njoh me RVB dhe gjithë dokumentacionin shoqëruar të tij. Pas shqyrtimit të RVB, GVJ ishte i gatshëm për vizitën 2-ditore në Universitetin "I. Qemali", Vlorë në Fakultetin e Shkencave Humane, Departamentin e Gjuhës dhe të Letërsisë që janë përgjegjës për realizimin e programit të studimit që do të vlerësoheshin.

Për shkak të pandemisë, vizita u shty dhe më në fund u krye në dt 22-23 dhjetor 2020 në formën online.

Grupi i vlerësimit të jashtëm i asistuar edhe nga specialistja e ASCAL-it Juna Mengri, sipas agjendës së dakortësuar filloi takimet, së pari me dekanen e këtij fakulteti, e cila pasi bëri një paraqitje të programeve të studimit që mbulon ky fakultet, të infrastrukturës dhe stafit akademik e mbështetës, ngriti shqetësimin e numrit të pakët të studentëve, në këtë program në veçanti, dhe në gjithë fakultetin e universitetin në përgjithësi. Ajo listoi një varg faktorësh objektivë për rënien e prurjeve të reja dhe parashtrroi masta që po ndërmerrn në këtë drejtim.

Pas kësaj GVJ u takua me të gjithë aktorët që krijojnë, por njëkohësisht dhe marrin cilësi, si: me grupin e hartimit të RVB, me stafin akademik, me studentët. Po kështu u vijua dhe me stafin mbështetës së realizimit të këtij program studimi, si: Drejtoria e Komunikimit dhe e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Edukimit, Sektorin e Kurrikulave, Zyrën e Shërbimit të Studentëve dhe Sektorin e Këshillimit të Karrierës, Zyra e Projekteve.

Takimet ishin te frytshme, pyetjet objektive dhe të gjithë u treguan të gatshëm për shpjegime dhe për paraqitjen e gjendjes sa më afër realitetit.

Pas kësaj u vijua me vizitën në bibliotekën e Universitetit, në ambientet e auditorëve dhe në vëzhgimin e mjeteve të nevojshme për mësim.

Në përfundim GVJ kërkoi materiale dhe dokumente shtesë, të cilat na u vunë pas disa ditësh në dispozicion.

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 09.04.2021, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 1/29 Prot, datë 09.04.2021. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë përcjell në ASCAL më datë 13. 04 2021, nëpërmjet sistemit AMS dhe me anë të shkresës me Nr. 617 Prot, datë 13.04.2021 "Përcjellje e komenteve mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Shqipe dhe Letërsi", ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga ekspertët e jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

# Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Gjuhë Shqipe dhe Letërsi” Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë.

## I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR


<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë (UV), është institucion publik i arsimit të lartë i krijuar me VKM Nr. 105, datë 28.02.1994. Në nenin 4 të Statutit të tij theksohet se UV ka për qëllim zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë, në shërbim të lirisë dhe diversitetit të ideve, për konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor, për rritjen e mirëqënies dhe dinjitetit njerëzor të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente. Programet e studimit të ofruara nga UV janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit kombëtar të arsimit të lartë dhe i përgjigjen interesave kombëtare në fushën e arsimit të lartë. Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë shqipe në Universitetin “I. Qemali”, Vlorë ofron programe studimi, të cilat nuk bien ndesh me interesin kombëtar, por janë në përputhje me parimet e Kushtetutës (neni 57), me Ligjin e Arsimit të Lartë nr.80/2105, statutin e Un. “I. Qemali”, Planin strategjik (2018-2024) të këtij universiteti.
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit i ofruar nga ky departament është në përputhje dhe synon të konsolidojë më tej vlerat akademike dhe kulturore kombëtare. Ky program është i ngjashëm në pjesën më të madhe të tij me programet e ofruara ng departamente simotra të Universiteteve të vendit tonë, të cilat kanë në bazë punën e akdemikëve si E. Çabej, Shuteriqi, Xhaxhiu, Demiraj etj. ( <i>Burimi: Dokumentacion, Evidenca 3</i> )
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Ky program studimi është çelur në vitin 2005 me urdhër të MASH të Republikës së Shqiperisë me nr. Prot. 5253, dt.22.08.2005. Programi i studimit Bsc Gjuhë Shqipe dhe Letësi ofrohet nga Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë shqipe qe është një nga departamentet e fakultetit të Shkencave Humane, i cili ka si mision dhe objektiv përgatitjen e mësuesve në këtë fushë studimi dhe punonjësve shkencorë të shkencave albanologjike.  Nga GVJ u vërejt se kjo është e shprehur në vendimin nr.20.dt. 9.01.2020 për miratimin e Rregullores së DGJL. Mendojmë se kjo rregullore ku shprehet misioni dhe objektivat duhej hartuar me parë. Ai kategorizohet në nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.  ( <i>Burimi: Evidencë I,1 rregullore e Departamentit GjL, neni 2 pdf</i> )

<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Programet e studimit u ripane dhe u hartuan sipas kërkesave të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015-2020), sipas kërkesave të Ligjit të Arsimit të Lartë (80/2015), i cili rrit konkurrencën midis IAL dhe në përputhje me nevojat e zhvillimit të rrethit të Vlorës si një qendër ekonomike e kulturor me potencial të vendit tone.</p> <p>(Burim: Plani Strategjik 2018-2024 i Un. "I.Qemali" të Vlorës)</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.2</b>  <b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Institucioni ka ndërtuar një plan strategjik që synon përmirësimin e kurrikulave dhe procesit të mësimdhënies në funksion të kërkesave aktuale të vendit dhe në përshtatje me kërkesat e punës të tregu. Departamenti i Gjuhës shqipe dhe i Letërsisë ka hartuar programet dhe i zbaton dhe zhvillon ato në përputhje me Planin Strategjik 2018-2024 të Un. "I. Qemali", por për t'i përshtatur ato me specifikat e veta, ka hartuar dhe zbaton Strategjinë e Zhvillimit të Departamentit të Gjuhë-letërsisë 2018-2024.</p> <p>(Burim: Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Gjuhë-Letërsisë 2018-2024)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstron se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Në statutin dhe rregulloren e institucionit përcaktohen qartë drejtimit prioritar akademike. GJV vlerëson se programi i studimit Bachelor në Gjuhë shqipe dhe Letërsi ofrohet në përputhje me drejtimit akademike të institucionit. Statuti (i miratuar më 01. 04. 2019 nga rektori i UV) dhe rregullorja (Evidenca I. 1 ) i kanë përcaktuar qartë drejtimit prioritar akademike.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Emërtimi i këtij program studimi në çelje të tij është bërë më 22.08.2005 me emërtimin Kursi i studimit Gjuhë-Letërsi. Me kohëzgjatje studimit 3+1, me kohë të plotë. Emërtimi sipas shkresës së hapjes (Shkresë Nr. 5352 Prot, datë 22.08.2005): Gjuhë-Letërsi Në VKM Nr. 638, datë 22.07.2015, figuron me emërtimin: Gjuhë Shqipe dhe Letërsi Tek UMASH Nr. 439, date 09.09.2011 per miratimin e formes se diplomes figuron me emertimin: Gjuhë Shqipe dhe Letërsi Ne perputhje me VKM e kuotave te 2015 dhe me Urdherin e miratimit te formes se diplomes ne 2011, emertimi i programit ne sistem behet nga Gjuhë Letërsi në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi.</p> <p>Me Vendim të Senatit N.23,2012 "Për Formatimin dhe ndryshimin e kurrikulave" u bë organizimi dhe struktura e programit në përputhje me fushat e studimit akademik të përcaktuara në vendimin e mësipërm.</p>


	<p>Vërejtëm se emërtimi i Njësise bazë (departamentit) që ofron këtë program studimi nuk është unik, madje dhe në shkresat që Njësia bazë dërgon në dekanat apo rektorat. Ato janë herë me emërtimin <i>Departamenti gjuhë –letërsi</i> dhe herë me atë <i>Dep. Gjuhë shqipe dhe letërsi</i>. Bazuar ne Statutin e Ri te viti 2019 neni 10 pika 4 emertimi i ketij departamenti eshte Departamenti i Gjuhes Shqipe dhe Letersise</p> <p>(Burimi: Mjafton të shihet evidenca 1/3 Raporti i analizës së tregut të punës, ku shkresat ndjekin njëra-tjetrën, emërtimi nuk del i njëjtë.)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Gjuhë shqipe dhe Letërsi i ka përcaktuar qarte në çdo dokument, në Strategjinë e Departamentit dhe në çdo silabus objektivat për të formuar mësues dhe studiues shkencorë në fushat e filologjisë dhe letersisë</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Ky program studimi i nivelit <i>bachelor</i> nuk jep shumë mundësi për punësimin e studentëve. Mundësia për punësim rritet pas kryerjes së “Master i Shkencave në mësimdhënie në gjuhë dhe letërsi”</p> <p>GVB jep përgjigjen në raport se numri aktual i të punësuarve që kanë mbaruar Bachelor, sipas letërkëmbimit me DAR (tani ZVAP) është 19 pa specifikuar në arsimin publik apo privat.</p> <p><i>Konstatuam</i> pas shqyrtimit të letërkëmbimit (Evidenca1/4) ku dekani i drejtohet me kërkesë Dar-it më 2.4.2019 se sa të diplomuar ka me “Master i shkencave në mësimdhënie ...”, përgjigjja e Darit është se prej 2011 ky numër është 19. Pra nuk janë me Bachelor, si paraqitet në raport, por Master.</p> <p>Studimi i tregut të punës dhe punësimi i studentëve nuk ka qenë periodik dhe bazuar mbi një databazë, por spontan.</p> <p>Kurse Zyra e kurrikulës ku një nga sektorët ishte dhe ai i Alumnit na konfirmoi që kemi databeiz për gjurmimin e studentëve dhe të punësuar janë 15-16 (jo si pergjigjja e stafit të departamentit)</p> <p><b><i>Me këtë rast GVJ rekomandon te kryhen studime periodike te tregut te punes per kerkesat dhe nevojat e tij per kete program studimi.</i></b></p>




<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Ky program studimi ka një bazë të qëndrueshme njohurish për përgatitjen e studentit për të përballuar sfidat e tregut të punës në mësuesi, redaktori, bibliotekonomi, por nuk ka silabuse për të përgatitur studentë që do të punojnë në arkivistikë apo trashëgimi kulturore (fusha e historisë)siç përshkruhet në RVB. Pyetjes së eksperteve për këto drejtime pëdagogët iu përgjigjën se studentet janë punësuar dhe në këto fusha.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi I.4</b>  <b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b></p>				
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>			
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Universiteti “I. Qemali” i Vlorës, në përbërje të së cilit është dhe Departamenti Gjuhë –Letërsi, ka një përvojë prej tri dekadash dhe ka krijuar burimet dhe kapacitetet e duhura për ofrimin e këtij programi studimi duke rekrutuar një staf akademik me aftësi shkencore për këtë fushë studimi.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha e këtij programi studimi është në përputhje me drejtimin e fakultetit të shkencave huamane. Ai është në përputhje me ligjin e Arsimit të lartë 80/2015 si dhe në përputhje me parimet dhe standardet e Hapësisirës Euroipiane të Arsimit të Lartë.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit që ofron Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letësisë është në përputhje me fushën akademike të kësaj njësie bazë, e cila ka të bëjë me studimet letrare dhe gjuhësore. Hartimi i këtij programi është bërë sipas udhëzimeve kombëtare si Vendim 41.24.01.2018.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



**Standardi I.5**

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Universiteti "I.Qemali" i Vlorës në bazë të LAL 80/2015 dhe Stautit të Un Vlorës (2019) ka siguruar një bashkëpunim si me njësinë kryesore Fakultetin e Shkencave Humane ashtu dhe me DGJL në përbërje të këtij fakulteti. Dokumentacioni bashkangjitur RVB flet për një bashkëpunim të mirë institucional midis këtyre njësive.</p> <p>Në rregullore përcaktohet se departamenti për mbarëvajtjen e mësimdhënies ngrë grupin mësimor i cili harton programet, organizon dhe monitoron procesin mësimor.</p> <p>Mbledhja e departamentit është institucioni në të cilin caktohen titullarët e lëndëve dhe moduleve. Në mbledhjen e departamentit diskutohet dhe vendoset dhe për propozimet për përmirësime të syllabuseve.</p> <p>FSHH ka procedura të standartizuara për përditësimin e syllabuseve, aprovimin e literaturës etj.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Universiteti i Qemali i Vlorës, për realizimin e procesit mësimor dhe formues ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me Univeresitet homologe dhe institucione brenda vendit si me Qendrën e studimeve albanologjike (ASA), Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Univ. e Mesinës, Un.e Lecces, Un. Barit, të Pekinit etj.</p> <p>IAL nuk ka bashkëngjitur dokumentacionin për marrëveshjet e bashkëpunimit, këtë informacion GVJ e ka marrë gjatë takimit me NJSBC-në dhe Raportit të vlerësimit të brendshëm.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>DGjL ka hartuar në mënyrë periodike raporte per njësinë kryesore. Në këto raporte që gjenden në Evidencën 1/8 për "Analizën vjetore të veprimtarisë së DGJL" për vitin akademik 2017-2018 dhe 2018-2019 gjetëm ndonjë aktivitet (në formën e konferencës) zhvilluar në bashkëpunim me Un.e Beogradit apo QSA, por jo analizë për bashkëpunimet.</p> <p><i>GVJ rekomandon që njësia përgjegjëse për programin e studimit të hartojë raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Ky program studimi në nivel Bachelor nuk ofron kryerjen e praktikës. Ajo realizohet në nivelin e Masterit Shkencor në Mësimdhënie.</p>

<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Institucioni nuk ofron trajnime të mëtejshme për studentët e diplomuar, por ato realizohen jashtë institucionit prej Qendrës studimore ndërdisiplinore të zhvillimit rajonal.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
<b>I</b>				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit në Bachelor Gjuhë shqipe dhe Letërsi është i organizuar në lëndë për të dyja fushat e studimit, Gjuhësi dhe Letërsi. Organizimi i programit është bërë në bazë të ligjit të AL 80/2015. Lëndët janë organizuar në module dhe të vlerësuara me Credite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Cikli i i parë i studimeve ka në total 180 kredite, dhe çdo vit akademik ka 60 kredite. Raporti midis orëve në auditor dhe studimi individual është llogaritur sipas udhëzimeve përkatëse.
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Programi i studimit në Bachelor Gjuhë shqipe dhe Letërsi jep njohuri për drejtimet mësuesi, studiues lëtërsie e gjuhësie. Nuk krijon mundësi për më tepër specialitete për vetë natyrën e fushave të studimit. Vërejtëm në raport e VB se pretendohet që ky program studimi, me njohuritë që jep i pajis studentët me aftësi edhe në fushat: Studime kulturore, Trashëgimi kulturore, Arkivistikë, Muzeologji, Sisteme informacioni dhe Turizëm. Në silabuset e këtij programi studimi nuk pamë lëndë që të mbulojnë fusha të tilla të tregut të punës dhe as janë diku qëllimi dhe objektivi i kësaj fushe studimi. Ndonjë disiplinë, si Lënda <i>Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit</i> jep vetëm disa njohuri empirike kompjuterike të mjaftueshme për një student dhe nuk përgatit specialistë për Sisteme informacioni etj.
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparura në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të	Programet e studimit të ciklit të parë janë në përputhje me njohuritë shkencore dhe akademike të kësaj fushe. Ato janë mbështetur në traditën më të mirë shkencore, duke u integruar me përditësimin e teorive më të reja. Vështirësia ka qenë më e madhe në fushën e

kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	letërsisë për shkak të objektit të këtyre lëndëve, por edhe këtu janë bërë përpjekje veçanërisht për të ndërlidhur njohuritë akademike me ato praktike, për të zhdërvjelltësuar komunikimin gojor me atë të shkruar.			
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit të ciklit të parë Gjuhë shqipe dhe Letërsi zhvillojnë njohuri që i përgatisin profesionalisht studentët si në gramatikë, probleme të shqipes standarde, të sociolinguistikës, analizave të veprave letrare etj. Zhvillimi i seminareve dhe ushtrimeve në këto disiplina i aftësojnë studentët në zgjidhjen e problemeve që mund të dalin në të ardhmen në punën e tyre.			
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Programet e studimit përmbajnë të gjitha elementet të përcaktuara në LAL 80/2015 si dhe në VKM nr.24 dt 12. 01. 2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Si elemente permenden: plani mësimor, struktura e krediteve që ekujvalenton ngarkesën e programit, silabuset, tipologjinë e veprimtarisë së kryer në kuadër të programit, instrumentet e vlerësimit dhe Supplementin e diplomës. Te gjitha këto gjenden në dosjen e RVB.			
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	<p>Programet e studimit janë të grupuara në lëndë, këto në modulet përkatëse dhe në kredite që shprehin ngarkesën për leksionet/seminare.</p> <p>Programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS dhe janë të grupuara në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kategoria A: Lëndë bazë 32 ECTS (17.7%)</li> <li>- Kategoria B: Lëndë karakterizuese 94ECTS (52%)</li> <li>- Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese 22 ECTS (12.2%)</li> <li>- Kategoria D: Lëndë plotësuese 26 ECTS (14,4%)</li> <li>- Kategoria E: Detyrime përmblyëse 6ECTS (3.3%)</li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## Standardi II.2



**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia kryesore, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë që janë përgjegjës për realizimin e programit të studimit i përmbushin kërkesat dhe detyrimet e Ligjit për Arsimin e Lartë në RSh nr.80/2015.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton	Në raport dhe në dokumentacionin bashkangjitur (Evidenca II,4 Kordinatorët për studentët) del se në mbledhjen e dekanatit

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tcl:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





<p>një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>të dt 14.01. 2019, për secilin departament të Fakultetit të Shkencave Humane është emëruar një <i>Kordinator për studentët</i>, (për DGJL, E. Hudhëra). Pra, nuk është emëruar Kordinator për programet. Në raportin e VB thuhet se këtë detyrë e ka kryer si traditë <i>Këshilltari akademik</i>. Nuk është detyrë e Kordinatorit ecuria dhe punësimi i studentëve e as paraqitja prej tij dhe e përgjegjësit të Departamentit të programit mësimor. Ky i fundit për çdo lëndë prezantohet dhe sqarohet nga pedagogët përgjegjës. Kordinatori mendojmë se duhet të ndjekë më mirë zbatimin e programit të studimit.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënlige për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Njësia kryesore dhe Departamenti i GjL në përbërje të tij i përmbush detyrimet e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 si dhe të akteve nënlige në fuqi.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Kjo njësi i përmbush kërkesat e nenit 25, pika 4 të Ligjit të AL 80/2015 për kualifikimin e stafit akademik. Në këtë departament zhvillojnë mësim 13 anëtarë me kohë të plotë nga të cilët 3 me gradën prof.dr., 2 me gradën shkencore prof/as dhe 8 me gradën dr. Po kështu dhe pedagogët e jashtëm të fuar, janë me gradën prof. dr dhe prof.as.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënlige për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Kjo njësi ka në përbërje si strukturë: përgjegjës të departamentit, 13 pedagogë me kohë të plotë, 2 përgjegjës (nga profesorët) të Grupeve kërkimore- shkencore dhe një pjesëtare e sekretarisë mësimore që administron dokumentacionin Në raport flitet edhe për Kordinatorin e programit, megjithëse ky emërohet dhe nga Dekani dhe në raport Kordinatori i studentëve.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

### Standardi II.3

**Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Gjuhës shqipe dhe i Letërsisë disponojnë gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin dhe përmbajtjen e programit. Kjo duket nga dokumentacioni dhe marrëdhëniet shkresore me dekanin dhe rektorin.  Në dosjen e programit që GVJ ka në dispozicion gjendet informacioni për institucionin dhe për strukturën e programit të</p>




	<p>studimit, informacion për strukturën akademike përgjegjëse dhe strukturat bashkëpunuese, kuadri i përgjithshëm formues i programit, të dhënat për personelin akademik për realizimin e programit, plani mësimor, infrastruktura në dispozicion të programit, kriteret e pranimit, rregullorja e programit, syllabusët e lëndëve dhe suplementi i diplomës.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Në bazë të VKM nr.41. dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e arsimit të lartë” programi i studimit është organizuar në disiplina gjuhësore dhe letrare, këto të organizuar në module të cilat rrealizohen brenda një semestri dhe që çdo modul, përbën një pjesë të programit të lëndës, i cili përmbledh në mënyrë të logjikshme, të vazhduar, të rregullt dhe të organizuar tematika të ngjashme.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Sipas VKM nr.41. dt. 24.01.2018 Programi i studimit duhet të përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS. Edhe DGjL i ka organizuar, siçpërkruhet në RVB në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>i) Lëndë bazë të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme;</li> <li>ii) Lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik;</li> <li>iii) Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje;</li> <li>iv) Lëndë plotësuese, të fokusuar në përfundimin e aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike;</li> <li>v) Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar.</li> </ul> <p>Në tre vite akademike realizohen 180 ECTS të grupuara sipas skemës së mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Kategoria A: Lëndë bazë 32 ECTS (17.7 %)</li> <li>– Kategoria B: Lëndë karakterizuese 94 ECTS (52.2%)</li> <li>– Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese 22 ECTS (12.2%)</li> <li>– Kategoria D: Lëndë plotësuese 26 ECTS (14.4%)</li> <li>– Kategoria E: Detyrime përmbyllëse 6 ECTS (3.3%)</li> </ul> <p>Kjo ndarje është në përputhje të plotë me kërkesat e parashtruara në VKM 41 dt. 24.01.2018 sipas së cilës pesha specifike e kategorive të veprimtarive formuese duhet të jetë 15 – 20 % për kategorinë A, 50 – 55 % për kategorinë B, 12 – 15% për kategorinë C, 10 – 15% për kategorinë D, 3 – 5% për kategorinë E.</p> <p>Vumë re në RVB që nuk kishte uniformitet në paraqitjen e silabuseve në emërtimet e lëndëve, diku quheshin lëndë të formimit të përgjithshëm po të njëjtat diku quheshin bazë; diku lëndë formuese e diku po të njëjtat, plotësuese.</p>



	<b>GVJ rekomandon rishikimin e syllabuseve dhe përditësimin e tyre.</b>
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Programet e studimit janë shoqëruar nga përgjegjësi i Departamentit edhe me planin mësimor ku është detajuar në orë ngarkesa në auditor për çdo lëndë. Mënyra e frekuentimit dhe e shlyerjes dhe vlerësimit janë vendosur në fund të çdo silabusi nga pedagogët përgjegjës. (Evidenca II, 5 Silabuset) dhe (Evidencë III Programi akademik për vitin 2019-2020 Bachelor)
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit që ofrohet nga DGjL përmban informacione për studentet në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit e transferimit të studentëve, ekuivalentimin e studimeve të cilat përshkruhen në vendimin e Senatit të UVdt. 21.01. 2020.  Në takimin me studentët GVJ konstatoi se studentët kishin informacion për kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit Bcs në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi përmban syllabuset e detajuara për secilën lëndë. Në syllabuse gjendet informacioni për tipologjinë e lëndës, kreditet, shpërndarjen e orëve në auditor dhe jashtë tij, vitin dhe semestrin në të cilin zhvillohet lënda? Syllabusi jep informacion për lëndën, objektivat dhe rezultatet e pritshme. Gjithashtu jepen temat dhe ka informacion për frekuentimin dhe mënyrën e kontrollit të dijeve. Në syllabuse është specifikuar literatura bazë dhe literatura e rekomanduar Paraqitja e tyre duhet të jetë e unifikuar. Ka disa raste ku megjithëse struktura e silabusit është e njëjtë për të gjithë, nuk është plotësuar njësoj. Në Evidencën I.1 Rregullore e DGJL, neni 14/4 ku përshkruhen format e mësimdhënies, krahas leksioneve dhe seminareve, flitet edhe për orë laboratorike në <i>Fonetikë</i> dhe në <i>Gjuhën e huaj</i> (përkthim, interpretim). Nuk pasqyrohen këto orë laboratorike as në silabuse e RVB e as i pamë kur vizitua ambiente, madje si pikë të dobët infrastrukturore stafi akademik na tha se kanë pikërisht mungesën e një laboratorit të <i>Fonetikës</i> .  <b>GVJ rekomandon që syllabuset të formatohen në përputhje të plotë me kërkesat e VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” dhe të unifikohen nga të gjithë pedagogët.</b>
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Nuk gjetëm për çdo vit akademik ose në vite të afërta miratim ndryshimesh në përmbajtjen e programeve mësimore. Duhet vërejtur se ndryshimet në program të përvitshme në fakt janë disi më të rralla se në fushat e shkencave ekzakte. Dokumenti që duhet t’i referohemi sipas RVB del bosh (Evidenca II .8

	<p>Miratimi i teksteve mësimore të programit të studimit të DGJL-së për vitin akademik 2016 - 2017'.PDF)</p> <p>Nga Zyra e Kurrikulës na u bë me dije se po përpiqen të kërkojnë nga departamentet të përditësojnë literaturën shkencore për çdo disiplinë dhe ta kenë të dokumentuar edhe këtu.</p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përbushjes</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X	

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ngarkesa e programit, megjithëse edhe në RVB theksohet mbështetja në aktet ligjore e nënligjore duhej strukturuar më mirë. Me të njëjtën ngarkesë (8) kredite rezultojnë të gjitha lëndët, pavarësisht rolit që ato luajnë në formimin e studentëve.
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Emërtimet e lëndëve dhe shpërndarja e tyre sipas viteve mundësojnë krijimin e aftësive të studentëve në këtë fushë studimi, me të cilat do të vijojnë studimin në Master Shkencor të Mësuesisë. <ul style="list-style-type: none"> <li>Vërejtëm se në disa raste e njëjta lëndë del me emërtime të ndryshme. Kurse në RVB Standardi III 7/1 në lëndët plotësuese flitet për Njohuri informatike kur në silabuse gjendet me emërtimin <i>Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit</i>.</li> </ul> <p><b><i>GVJ rekomandon përputhshmërinë e emërtimeve të lëndëve në Syllabuse dhe në planin mësimor.</i></b></p>
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Lëndët, modulet orët në funksion të tyre mundësojnë arritjen e objektivit kryesor, formimin e mësuesit të Gjuhës shqipe dhe të Letërsisë dhe pajisjen e studentit me njohuri gjuhësore e kulturore të aftë për t'u përballur në jetë me probleme të kesaj fushe studimi.
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre janë në përputhje me profilin e këtij programi.</li> <li>Ngarkesa në kredite për çdo disiplinë është e madhe dhe përveç <i>Gjuhës së huaj dhe Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit</i>, (Njohuri kompjuterike) (me nga 6 kredite) të gjitha të tjerat janë me 8 kredite, pa u dalluar njëra nga tjetra për specifikat dhe peshën që kanë në formimin e studentit.</li> </ul>






	<p>- Edhe disiplina formuese të zgjedhura nga studenti, (lëndë me zgjedhje), si Estetike apo Gjuhësi teksti etj. janë me 8 credite sa lëndët e formit bazë apo integruese.</p> <p>- Raporti teori /praktikë që për këtë program studimi është e tipit leksion/seminar është në përputhje me programe të ngjashme në universitet tona.</p> <p>- Ky program mundëson mobilitet të studentëve brenda dhe jashtë vendit, shprehur dhe në suplementin e diplomës.</p> <p><b><i>GVJ rekomandon rishikimin e shperndarjes së krediteve.</i></b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Për vetë natyrën e kësaj dege të dijes, jepen njohuri të zgjeruara të karakterit deskriptiv. Disa lëndë të formimit gjuhësor, si: Drejtshkrimi i gjuhë shqipe, Morfologji e Sintaksë kanë karakter praktik. Po kështu në letërsi Analiza e veprave letrare, Analiza e tekstit bëjnë të mundur gërshetimin e njohurive teorike me ato praktike.</p> <p>-Na duket ngarkesë e tepërt raporti 4/2 apo 3/2 (3 leksione dhe 2 seminare) në javë. Kjo është ngarkesë e madhe jo vetëm për studentin, por dhe pedagogun, e cila me siguri ul cilësinë e orës së mësimi dhe të përgatitjes nga ana e studentit.</p> <p><b><i>GVJ rekomandon rishikimin e raportit leksion / seminar ne auditor.</i></b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Silabuset të paraqitura në evidencën II 5, paraqesin temat dhe literaturën e detyrueshme dhe ndihmëse. Për vetë natyrën e gjuhësisë, studimet në të cilën janë disa më të rralla e me ndryshueshmëri jo të thella për nivelin e studentit, literatura përfaqësohet nga punimet bazë por edhe të dekadave të fundit, si <i>Hyrje në gjuhësi, Dialektologji</i> etj. Edhe në disipinat e letrësisë vërehet e njëjta dukuri, por literatura, përveç asaj të traditës përmban edhe atë më të re, me emra të rinj studiuesish , si S. Hamiti, A. Tufa etj.</p> <p>Zyra e Kurrikulave na bëri me dije se është në planin e punës të së ardhmes për të kërkuar literaturën e përditësuar nga departamenti.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit, është një program i ngjashëm me të departamenteve të ngjashme në Universitet tona që ofrojnë këtë program studimi dhe tashmë është e provuar me dekada që garantojnë përfundimin e dijeve nga studentët e këtë e provon edhe mobiliteti i studentëve të cilët nuk hasin vështirësi. Ky program i realizuar mirë me bashkëveprimin pedagog/student i realizon synimet e tij.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të ofruar nga ky departament i jep mundësinë studentit të vijojë në ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave në Mësidhënien e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë”. Kjo vërtetohet edhe nga evidenca II 10 në të cilën pasqyrohen emrat e studentëve me mesataren përkatëse të cilët i përcillen Dekanatit për vijimin e studimeve.</p> <p>Përmbajtja e këtij programi mundëson edhe punësimin qysh pas ciklit të parë për redaktor në institucione shtetërore ose në organe shtypi.</p>



<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Për t'iu përshtatur më mirë tregut të punës më 22 dhjetor 2019 është mbajtur në UV Workshop-i me temë:” Studentët dhe tregu i punës”.</p> <p>Nuk kemi të dhëna se çfarë u propozua nga partnerët dhe çfarë u sugjerua për programin në shqyrtim. Linku i vënë në raport nuk na jep të dhëna të tjera.</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi II.5</b>  <b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Ky departament ka në përbërje të tij Personel akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit dhe përbushin kërkesat ligjore në fuqi (LIGJ Nr. 80/2015 për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë” neni 59, pika 3, 4,5)</p> <p>Shpërndarja e titujve dhe gradave është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 3 PAE me titull akademik Prof. Dhe</li> <li>- 2 PAE me titull akademik Prof. Asc.</li> <li>- 9 PAE me gradën shkencore Doktor</li> <li>- 1 PAE me diplomë Master i Shkencave</li> <li>- 1 PAK me gradën shkencore Doktor</li> </ul> <p>Titullarët e lëndëve/moduleve janë me titull Prof., Prof. Asc. ose me gradën Doktor .</p> <p>Kategorizimi i pedagogëve në Lektorë dhe Asistent Lektorë bazohet në kërkesat e Ligjit në fuqi. Lektorët janë me titull Prof/Prof. Asc. ose me gradën Doktor;</p> <p>2 Asistentë Lektorët kanë diplomë të ciklit të dytë të studimeve, Master të Shkencave dhe janë pedagogë me kohë të pjesshme, të cilët mbulojnë lëndë specifike (gjuhën e huaj dhe njohuritë kompjuterike)</p> <p>Sipas pikës 2 të Ligjit të mësipërm në RVB stafi akademik duhej paraqitur sipas emërimeve: a) profesorë; b) lektorë; c) asistent-lektorë.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në</p>	<p>Stafi akademik i DGJL në UV është një staf me përvojë në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor, i cili ka kualifikimin e nevojshëm për realizimin e programit të studimit. Ai është i kualifikuar dhe ka në përbërje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 3 PAE me titull akademik Prof.</li> </ul>

<p>mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- 2 PAE me titull akademik Prof. Asc.</li> <li>- 9 PAE me gradën shkencore Doktor</li> <li>- 1 PAE me diplomë Master i Shkencave</li> <li>- 1 PAK me gradën shkencore Doktor</li> </ul> <p>I gjithë programi i studimit mbulohet nga 16 pedagogë në raportin 15 PAE/ 1 PAK.</p> <p>Ngarkesa mësimore vjetore për personelin akademik me kohë të plotë në auditor brenda këtij institucioni është:</p> <p>a) Kategoria Profesor 140 ore mesimore ne auditor; b) Kategoria Lektore 165 orë mesimore ne auditor;</p> <p>Për stafin akademik të jashtëm ngarkesa është 120 orë ne auditor (janë kategoria Lektor).</p> <p>Nga PAE mbulohen 164 kredite, kurse nga PAK 16 kredite ose -91.1% e ngarkesës mbulohet nga PAE -8.9% e ngarkesës mbulohet nga PAK</p> <p>Në këtë program studimi nuk ka anëtarë të stafit akademik që mbulon më shumë se 3 lëndë, por po të kemi parasysh se pothuaj të gjithë pedagogët e kësaj njësie japin mësim edhe në ciklin e dytë të studimeve, ky numër kalohet.</p> <p>Në punën e këtij departamenti vërehet edhe një kordinim midis punës së stafit më të moshuar me atë më të ri. Lëndët e formimit bazë si: Hyrje në gjuhësi, Letërsi botërore, Folklor, etj i mbajnë pedagogë me përvojë dhe të kategorisë Profesor.</p> <p>Në evidencën VI.5 (Vlerësimi i performancës së stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjeshme) stafi akademik plotëson skedën me kërkesat e performancës gjatë vitit akademik.</p> <p>Na duket numër fare i vogël vendosja e kriterit, një artikull shkencor në vit. Nga pyetjet drejtuar stafit të këtij departamenti na u tha se është vendosur nga Senati Akademik.</p> <p>Megjithatë, nga kqyrja që GVJ i bëri dokumentit 3 (Puna shkencore e stafit akademik në 5 vitet e fundit), dokument që u kerkua prej nësh, u pa qartë se stafi akademik është përfshirë gjatë kësaj periudhe në një punë shkencore intesive, me artikuj të botuar, libra dhe pjesëmarrje në konferenca.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Fusha e kualifikimit të përgjithshëm dhe specifik të anëtarëve të stafit akademik të DGJL është në përputhje me programin e studimit. Të gjithë anëtarët e stafit akademik zhvillojnë mësim në disiplina të njëjta ose shumë të përafërta me temat e doktoraturave të mbrojtura prej tyre. Nga krahasimi i CV-ve (evidenca I.7) dhe sylabuseve të lëndëve (evidenca II.5) u pa që ka përputhje.</p> <p><b><i>Do të sugjerim që CV (Jetëshkrimet) e stafit akademik të plotësoheshin njësoj dhe të unifikoheshin sipas formatit Cv Europass.</i></b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e</p>	<p>Studentët në ciklin e parë të studimeve nuk kryejnë praktikë mësimore (kryhet semestrin e 4-t të MSH).</p> <p>Nga RVB, por dhe në takimet me stafin akademik na u bë me dije se pas ciklit të parë të studimeve zhvillohet një provim diplome me gojë (Evidenca II 11 Programet e provimit të formimit). Ky provim zhvillohet me gojë mbi njohuritë bazë të gjuhësisë dhe letërsisë.</p>

studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	<p>Pyetjes sonë se përse nuk ka tema diploma të udhëhequra nga pedagogë të departamentit, stafi na u përgjigj se nuk ka studentë me mesataren që kërkohet për të marrë temë diplome.</p> <p>Në takimin me studentët, disa prej tyre na thanë se janë me mesatare të mirë, madje mbi 9 (nëntë).</p> <p>Udhëheqja e diplomës jo vetëm që është një angazhim detyrues për stafin, por dhe studentët që kanë mundësi dhe dëshirë për punë shkencore i fut në një hulli ndryshe që i paraprin punës kërkimore-shkencore në të ardhmen.</p>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	<p>Mjediset mësimore ishin të mjaftueshme për zhvillimin e këtij program studimi. Për shkak të natyrës së këtij programi studimi (program në lëndët shoqërore) nuk ka orë laboratorike enkas në realizimin e moduleve të veçanta, prandaj nuk ka personel ndihmës mesimor-shkencor.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

#### Standardi III.1

**Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>Universitetit të Vlorës, Rektorit i është paraqitur nga Qendra e Zhvillimit Rajonal një “Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit” me shkresë Nr.33/3, dt. 01.02.200</p> <p>Në RVB, (Evidenca N) ku gjendet shkresa e kësaj qendre ndodhet edhe shkresa ku Rektorati e aprovon më 13. 01.2020. këtë Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit. Duke parë kohën se kur është zhvilluar kjo korrespondencë shkresore dalim në përfundimin se Institucioni kërkon të implementojë metoda inovative, por ato ende nuk janë futur në zbatim.</p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Në UV është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit (NJSBCV).</p> <p>Sipas stafit akademik janë kryer edhe vlerësime të mëparshme, nga vetë departamenti, por jo me një strategji të përcaktuar (Nuk kishte dokumentacion). Ky është vlerësimi i parë që bëhet për këtë program studimi nga ASCAL.</p> <p>NJSBCV në rang Universiteti ka kryer një testim me studentët, viti 2017-2018 dhe 2018-2019 me 14 pyetje (2 të hapura). Eshte zhvilluar duke e dërguar pyetsorin në adresën e secilit student për të vlerësuar mësimdhënien dhe stafin akademik dhe një pyetsor, sipas RVB për vlerësimin e Shërbimeve Administrative.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Grupi i vlerësuesve të jashtëm nuk e patën Pyetsorin. Me kërkesë të GVJ u dërgua Pyetsori për Vlerësimin e cilësisë së Mësimdhënies me 14 pyetje (dhe 2 pyetje të hapura) (Shih. Vizita dyditore, dokumenti 1)</li> <li>- U dërgua dhe Pyetsori për Stafin Administrativ dhe ndihmës Akademik. Ky pyetsor i pasur, duhet të përshtatet për studentët e këtij program studimi, sepse në të, për vetë natyrën e lëndëve shoqërore, nuk ka staf ndihmës Akademik. Për këtë pyetsor, studentët e pyetur nuk kishin dijeni që ta kishin kryer.</li> <li>- Pyetsori i parë na u bë me dije se është vendosur nga Institucioni të bëhet në fund të çdo semestri.</li> <li>- Mendojmë se dërgimi në adresën e secilit student nuk krijon privatsi dhe përgjigjet janë të kompromentuara, aq më tepër që nr. i studentëve është shumë i vogël.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Pyetësori mbi cilësinë e mësimdhënies shihet nga stafi si një nga mënyrat e përfshirjes së studentëve në vlerësim, prandaj kanë ndërmarrë si universitet hapa për përmirësimin e Pyetsorit për vlerësimin e cilësisë së pedagogëve dhe mësimdhënies.</p> <p>Gjate muajve Janar-Shtator 2020, anëtarët e Grupit të Punës të ngritur me Urdhër të Rektorit Nr. 123 prot, datë 19.12.2019, "Për ngritjen e Grupit të Punës për përmirësimin e pyetesorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi" kanë ndërmarrë hapa për përmirësimin e Pyetsorit. Shume nga pikat e reja që shtohen në pyetsor, GVJ i gjen me vend, por modeli që duan të zbatojnë, na duket disi i pamundur. Model merret pyetsori i aplikuar prej London School of Economics and Political Science. Në kushtet kur ky Universitetet dhe në veçanti ky program studimi po kalojnë pragun e parë të vlerësimit të cilësisë, nuk mund të bëhen matje cilësie me univeritet e mësipërme që i kanë kaluar disa herë vlerësimet e cilësisë. Qëllimi është largpamës, por matja e cilësisë kërkon objektivitet dhe paraqitje sa më të vërtetë e realitetit.</p> <p>Në rregulloren e Institucionit (UV) është miraturar me Vendim nr.102, 2017, në nenin 41 t'i jepet mundësia e ankimit studentit për rezultatin e provimit, të cilin e paraqet në sekretarinë mësimore dhe brenda 2 ditëve, departamenti është i detyruar nëpërmjet pedagogut përgjegjës të kthejë përgjigje. Kur studenti ka konflikt interesi me pedagogun kërkon edhe ndërrimin e tij.</p>

<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	NJSBCV është struktura përgjegjëse e këtij institucioni , i cili bën publike rezultatet e vlerësimit. Kështu rezultatet e vlerësimit të studentëve që sipas RVB u krye në janar-shkurt 2019 mbi bazë anketimi i është bërë i ditur Departamentit dhe ky ne dt 4.2.2020 i bën të njohur dekanit planin e masave për përmirësimi e cilesisë në DGjL, duke ruajtur dhe privatsinë e stafit.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	Në raportin vjetor të Departamentit (evidenca 1.8) merret në analizë cilësia, por nuk kanë praktikuar shembuj të inkurajimit apo vlerësimit të personelit akademik.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	


<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Për natyrën e kësaj fushe studimi, pjesë e shkencave humane, format tipike të mësimdhënies janë leksionet dhe seminarët, detyrat e kursit, të miratuara nga institucioni e të pasqyruara Edhe në Planin strategjik të DGjL (evidenca III 3)
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	Edhe nga RVB edhe nga takimi me studentet GVJ-ja u njoh me raporte të mira pedagog-studentë dhe për studentë me nevoja të veçanta stafi akademik ka qenë i gatshëm për të përshtatur mësimdhënien e mësimnxënien.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënies, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Institucioni e ka mbështetur vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e kompetencave didaktike duke lejuar fleksibilitet, si leksione të hapura (leksion i hapur ngaprof.as E. Manovi nga ASA), përdorimin e shpjegimit më poëer point etj. Duke pasur në gjirin e vet pedagogë me karrierë të gjatë në mësimdhënie, madje edhe metodistë të mirë që kanë qenë në drejtim të arsimit parauniversitar (prof. N. Mërkuri) aplikohen metoda të reja në mësimdhënie efikase për këtë program studimi.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është	Personeli akademik është i aftë në shpjegimin e njohurive që shtron ky program studimi, i përfshirë në kualifikimin shkencor dhe në

kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	aktivitete shkencore të kësaj fushe (konferenca, seminare, trajnime etj). Kualifikimi shkencor i stafit akademik është i përhershëm. Në përgjigjet e studentëve, performanca e përgjithshme e pedagogëve është mbi 60% shumë e mirë. (Evidenca 3 I Planini i masave për përmirësimin e cilësisë në DGJL)								
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Personeli akademik i kësaj njësie bazë në Planin e masave për përmirësimin e cilësisë së DGJL merr në analizë të hollësishme raportin e NjSBC dhe vlerëson vërejtjet e studentëve të dala nga anketimi, duke vënë në pah edhe hapat që do të behën për përmirësimin e pikave të dobëta të vërejtura në raport. Në rekomandimet që i bën punës së vet në të ardhmen për rritjen e cilësisë DGJL vëren: - rritjes së intesitetit gjatë orës së mësimin - përdorimi i metodave bashkëkohore në mësimdhënie - rritje të komunikimit pedagog-student - jo presion dhe dakordësi për notën me studentët etj.								
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.	Personeli akademik, në mënyrë të veçantë ai i disiplinave letrare i tërheq studentët në diskutime interaktive, duke lënë hapësirë që studenti të nxjerre në pah individualitetin etij, qëndrimet dhe vlerësimet për çështje të veçanat, madje duke diskutuar (siç u vu në dukje nga studentët edhe punëve të tyre letrare)								
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Studenti me metodat e mësimdhënies, literatura e rekomanduar, gjetja e ambienteve të punës në bibliotekën e UV-së si dhe marrëdhëniet jo pedante të pedagogëve, u japin mundësi studentëve për autonomi dhe një marrëdhënie korrekte e ndërsjellë respekti ndaj pedagogëve.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi III.3

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Fakulteti i Shkencave Humane ku bën pjesë DGJL ka ambiente të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e orëve të mësimin. Në vitin 2018 Godina e këtij fakulteti u rikonstruktua dhe në dispozicion të DGJL për zhvillimi e mësimin të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve janë 12 salla leksionesh dhe 3 seminaresh. GVJ iu



	dha mundësia për t'i parë. Ishin të pastra e plot dritë, të mirëmbajtura nga personel mbështetës (4 persona) në përbërje të organigramës së UV.
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Ambientet e dedikuara për mësim të Ciklit të parë të studimeve Gjuhë shqipe dhe Letërsi dukeshin funksionale (per shkak të pandemisë në to nuk kishte studentë), të pajisura me dërrasë të zezë e disa me ëhite board, me instalimet e nevojshme për të vendosur laptop ose videoprojektor, perde, videoprojektorë.
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Senati i UV me vendim nr.101 2017 vendosi krijimin dhe funksionimin e Platformës digjitale “Sistemi i manaxhimit të informacionit mësimor të UV”, platformë e cila funksionon. Çdo njësi kryesore, edhe FShH ka një personel të Strukturës së Teknologjisë së Informacionit (IT) Çdo student ka adresën e vet më të cilën komunikon me pedagogët dhe sekretarine <a href="mailto:emër.mbiemër@univlora.edu.al">emër.mbiemër@univlora.edu.al</a> . Në godinën B të Shkencave Humane ku kryejnë mësim studentët e GJL ka internet e po kështu edhe në ambientin e bibliotekës.
<b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Silabuset e lëndëve janë të shoqëruara të gjitha me literaturën bazë dhe të rekomanduar. Literatura është e përshtatshme dhe garanton marrjen e dijeve të nevojshme për studentët që ndjekin këtë program studimi dhe japin mundësi edhe për të ndjekur Ciklin e dytë të studimeve. Literatura dhe tekstet që vihen në dispozicion të studentëve aprovohet se pari në departament.
<b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Biblioteka kishte disa ambiente, me libra të ruajtura në kushte optimale, me botime që e mbulonin këtë program studimi. GVJ kërkoi disa tituj librash dhe punonjesi i bibliotekës na i vuri në dispozicion. Kohët e fundit kësaj biblioteke i ishte dhuruar një fond librash prej Akademisë së Shkencave. Ambienti ishte komod, me hapësira të mjaftueshme dhe nëpër tavolia kishte kompjutera. Salla ishte e pajisur edhe me internet.
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Si stafi akademik, ashtu dhe studentët kanë mundësi aksesimi në bibliotekën online <i>ULibrary</i> mundësuar nga MASR për UV. Aty gjendet literaturë e përafërt apo e ngjashme me programin e studimit. Shfrytëzimi bëhet duke u futur në faqen e universitetit, duke kërkuar manualin e përdorimit.
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Në FShH ekziston një laborator i gjuhëve të huaja, por për specifikën e programit të studimit të DGJL ai nuk shfrytëzohet për këtë program studimi.
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet	Personeli akademik nuk përdor platforma on-line (e-learning)

dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.									
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Nëpërmjet sistemit të brendshëm të komunikimit UVMS stafi akademik bashkëvepron me studentët. Pedagogu ngarkon në këtë sistem materiale mësimore, kontrollojnë detyrat e kursit etj. Studenti nëpërmjet këtij sistemi dhe adresës elektronike vetjake komunikon me sekretarinë.								
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asistion dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Në rregulloren e studimit, neni 19 (evidenca II 6 Rregullorja e programit të studimit) janë përcaktuar të gjitha hapat që duhet të ndjekë pedagogu për të udhëhequr një temë diplome të studentit. Për shkak të mesatres së ulët prej vitit 2016 –deri më 2020 nuk ka pasur udhëheqje për shkak të mesatares së ulët të studentëve. Në takimin me studentët na u pohua prej disave se kanë mesatare mbi edhe mbi 9.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies.	Në Un., “I. Qemali”, Vlorë janë ngritur dhe sanksionuar në Statutin e këtij universiteti për çdo fakultet Qendra të Kërkimit Shkencor. Në programin e studimit të marrë në shqyrtim ekziston Qendra e Kërkimit Shkencor të Albanologjisë dhe Ballkanistikës (Evidenca A, neni 11). Kjo është shprehur edhe në RVB, por duke parë funksionin e kësaj qendre nuk rezulton se ajo provon cilësinë e mësimdhënies dhe as e ka funksion të saj. Ajo nxit kërkimin shkencor në fushën e Albanologjisë, por jo cilësinë e mësimdhënies. Mbështetur edhe në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2105 në Statutin e këtij Universiteti është miratuar ngritja e Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSCBI) si dhe NJSCBV-ja të cilat janë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies dhe zbatimit cilësor të programit të studimit. Meqënese Statuti i UV është miratua më 2019 mendojmë se strukturat e mësipërme janë në hapat e para të ushtrimit të detyrës, prandaj dhe puna e tyre nuk ka prodhuar ende rezultat për periudhën të cilën po vlerësojmë.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Njësia kryesore, por edhe njësia bazë, DGJL, janë përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies. Për këtë arsye nëpërmjet NJSCBV kanë përdorur instrumente (pyetsori zhvilluar me studentët) për matjen e saj dhe përcëptimin e studentëve për cilësinë e mësimdhënies. Departamenti pas analizës së raportit të NjSCBV analizoi përfundimet dhe rekomandimet për përmirësimin e situatës ia përcolli dekanit në shkurt të 2020, ku theksoi rritjen e interesit




	gjatë orës së mësimi, përdorimin e teknikave të reja të mësimdhënies, përmirësimit e raportit pedagog- student ne lidhje me presionin e notës etj.			
<b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësiti përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Në nivel Universiteti është ngritur Qendra Studimore Ndërdisciplinore e Zhvillimit Rajonal (RDC) e cila ka hartuar një Udhëzues për përdorimin e praktikave dhe metodave të reja inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit. Ky Udhëzues është miratuar nga Rektorati, më 15.01.2020 dhe mendojmë se ende nuk janë vënë në zbatim (koha e shkurtër qysh prej miratimit), prandaj i mbetet së ardhmes.			
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Personeli akademik kualifikohet në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor dhe në mësimdhënie. Anëtarët e stafit akademik të DGJL janë aktivë në konferenca brenda dhe jashtë vendit, në revista e botime të fushës përkatëse (shih. CV e pedagogëve). Për të promovuar e mbështetur stafin e ri akademik, Senati i UV ka miratuar vendimin më 27.06.2018, “Për miratimin e strategjisë për trajnimin e vazhdueshëm të kërkuesve të rinj” Në kuadër të UV anëtarët e stafit akademik përmirësojnë nivelin e mësimdhënies edhe nëpërmjet projektit TAVET, tre vjeçar që ka filluar zbatimin qysh më 14 tetor 2017. Ky projekt është në bashkëpunim me MASR.			
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësiti përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Në RVB grupi i hartimi të raportit sqaron se UV nuk ka njësi përgjegjëse të trajnimit të stafit akademik. Në vendimin e senatit akademik të UV “Për miratimin e strategjisë për trajnimin e vazhdueshëm të kërkuesve të rinj (cituat më sipër), te pika 4 <i>Synimet strategjike</i> flitet për trajnime të vazhduara, trajnime për shkrim projektesh etj. Nga biseda me stafin akademik na u bë e ditur se institucioni mbështet financiarisht pjesëmarrjen në konferenca brenda e jashtë vendit.			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Stafi akademik dhe ai ndihmës-mësimor janë përgjegjës për mbarëvajtjen dhe zbatimin e programit të studimit. Puna e tyre është e sanksionuar edhe në Rregulloren e DGJL Neni 11.pika3 (evidenca I.1) Çdo vit përgatisin kërkesat dhe buxhetin përkatës për përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe ja paraqesin strukturave drejtuese të dekanatit.			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësiti përgjegjëse.	Stafi akademik në varësi të vlerësimeve të studentëve (pyetsorët) dhe të feedback-ut që marrin në auditor në takimin e afërt me studentët përshtasin dhe testojnë mënyra të reja mësimdhënies. Duke krahasuar rezultatet e testimit me studentët për vitet 2017-2018 dhe 2018 -2019 u vunë re ndryshime në perceptimin e studentëve për mësimdhënien dhe pyetjes mbi inkurajimin e diskutimit në auditor nga pedagogu. Nga pyetja e studenteve te Vitit III na u pohua se vetem nje herë në shtator 2020 kanë plotësuar një të tillë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

**Standardi III.5****Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimiit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Mënyra e vlerësimit të studentëve, mënyra hartimit të tezës së kontrollit të dijeve, lloji i provimit (me shkrim apo me gojë), rruga e ankimit të rezultatit të provimit, rishikimi i provimit, rastet e konfliktit të interseit me pedagogun dhe marrja në provim nga pedagogë të tjerë, koha e përgjigjes së rezultatit (48 ore) janë të përcaktuara në rregulloren e DGjL (evidencë II.6 Rregullorja e programit të studimit). Studentit i lihen komente dhe rekomandime ne korrigjimet e testeve. Këto u konfirmuan dhe nga sekretaria mësimore dhe studentët.			
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Studentët e vitit të parë të ciklit të parë të studimeve, njihen qysh në fillim të këtij programi studimi prej pedagogëve të lëndëve përkatëse për mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe vlerësimit të njohurive. Këto janë të shprehura në fund të çdo silabusi (Evidenca II.5 Silabuset), në Rregulloren e Programit të studimit (Evidenca II.6 Rregullorja e programit të studimit, 2020) si dhe iu bëhet e ditur edhe prej kordinatorit.			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi i njohurive të studentëve zhvillohen me shkrim, me gojë ose i kombinuar, kjo në varësi të natyrës së disiplinës dhe mënyrës se si e ka vendosur pedagogu në Silabusin përkatës. Këto janë të përcaktuara dhe në Rregullore (Evidenca II.6). Meqenëse numri i studentëve të të gjithë viteve të këtij cikli studimi (viti I 7 studentë, Viti II 15 studentë dhe viti III 22) janë në numër të pakët, kjo jep mundësi për një kontroll më të mirë, më të shpejtë dhe me kombinim.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi III.6****Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Testimi i njohurive të studentëve, dijeve dhe aftësive profesionale realizohen gjatë gjithë vitit akademik. Pedagogët zhvillojnë provime të pjeshme të lëndës si dhe detyra kursi, të cilat iu bëhen të ditura nga pedagogët qysh në fillim dhe janë të shprehura dhe në Sylabuset. Po kështu, viti akademik është i ndarë në semestrin e pranverës, semestrin e verës dhe semestrin e vjeshtës. Në fund të të gjitha këtyre realizohen provime. Në raste të veçanta, të parashikuara në rregulloren e UV çelen edhe minisezone provimesh.





<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Aktualisht në UV nuk ka dhe as është zbatuar sistem elektronik i kontrollit të dijeve i cili do të eliminonte format e abuzimit. Megjithatë numri i vogël i studentëve, mendojmë se lejon më tepër transparencë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Testimet dhe vlerësimi i njohurive bëhet nga komisionet lëndore (Evidenca III 12) me jo më pak se dy pedagogë, nga të cilët njëri është titullari i lëndës.. Për Provimin e Formimit nga përgjegjësi i departamentit ngrihet një komision prej 5 anëtarësh.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Në UV, përkatësisht dhe në programin e studimit që ofron DGJL testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, <i>nuk zhvillohet</i> në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim, pavarësisht se është parashikuar në Rregulloren e UV (Evidenca C Rregullore e UV)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Në takimin me pedagogë e studentë, na u sqarua se çdo studenti në fund të provimit me shkrim i lihen komente gjatë korrigjimit dhe me gojë po e njejta mënyrë, në mënyrë që studentit të sqarohet për problemet që nuk ka sqaruar mirë. Kjo nga ana tjetër sqaron dhe vlerësimin e pedagogut. Pas dy ditësh të korrigjimit (kaq është koha e pritjes së rezultatit) studentit që nuk i kanë mjaftuar sqarimet me shkrim ka të drejtë edhe të takojë pedagogun</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse DGJL dhe personeli akademik përpiqen ta shmangin plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. Të gjitha këto nuk tolerohen. Këto dolën edhe gjatë pyetjeve me studentët. Në raportin e VB thuhet se dhe këto janë shprehur edhe Rregulloren e programit të studimit 2020 (Evidenca II 6, neni 16, 17). Nga kontrolli ynë këto nene nuk gjenden (ndërpritën te neni 14 dhe rifillojnë te neni 18)</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. Në fund të çdo silabusi janë përcaktuar detyrimet e lëndës që nga frekuentimi, detyra e kursit, provimi i pjesshëm etj, të gjitha në përqinde, të cilat bashkë me provimin përfundimtar përbejnë një shumatore pikësh që garantojnë meritën e çdo studenti.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Këto i përmendëm edhe më lart. Studenti, si është pasqyruar në rregulloret e Programit të Studimit, por dhe nga bashkëbisedimi me sekretarinë mësimore, studenet dhe pedagogët, njihet me rezultatin e provimit pas 48 orësh dhe në se do të sqarohet me tej nga pedagogu, lihet takim me të.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm.</p>	<p>Në se ka kërkesë, ankimim nga studentit, të gjitha janë përcaktuar në dokumentacionin përkatës të UV, FShH dhe të DGJL (Evidenca C, Evidenca II, 2). Në se studentit nuk bindet për vlerësimin</p>

Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	përgjegjësi i Departamenti ngre komision ad hock i cili brenda 48 orësh është i detyruar t'i ktheje përgjigje studentit. Nuk ka pasur asnjë rast të tillë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.7

**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit Bsc Gjuhë dhe Letërsi Shqipe i ofruar nga DGJL është strukturuar për herë të parë me vendim Senatit A akademik nr. 23, dt 18.09, 2012 "Për miratimin dhe disa ndryshime të kurrikulave te programeve akademike në Universitetin "I. Qemali", Vlore. (Shih Evidenca 1), Qysh atëherë është përmirësuar duke pasur parasysh nevojat dhe njohuritë që iu duhen studentëve për të nesërmen. I ndarë në dy grup lëndësh: gjuhësi dhe letërsi është pasur parasysh që në të parën të krijohen njohuri të mira bazuar në traditën filologjike dhe në njohuri bashkëkohore. Po kështu edhe në fushën e letërsisë. Për këtë një ngarkesë të kenaqshme orësh zënë lëndët praktike, por dhe ato të formimit teorik (drejtshkrim, gramatikë, letrësis shqipe dhe botërore etj.) Syllabuse që mbulojnë lëndët e letrësisë iu japin mundësi studentëve me prirje letrare t'i zhvillojnë më tej ato.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Si program studime që mbulon një fushë të shkencave humane, pothuajse të gjitha lëndët e kanë në bazë komunikimin. Për të zhvilluar aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit dhe gjuhës së huaj, si lëndë plotësuese janë përfshirë në program me nga 6 ECTS: Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit si dhe Gjuha e huaj.
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Objektivat e çdo lënde janë vendosur në krye të çdo silabusi. Njohuritë dhe përfitimi që ka marrë studenti nga lënda përkatëse përkthehet edhe në notën me të cilën i janë vlerësuar dijet në provimin përfundimtar.
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Përpara provimit përfundimtar stafi akademik zhvillon edhe konsultime dhe orienton studentin drejt çështjeve thelbësore të disiplinës. Për këtë studentët njoftohen edhe për vendndodhjen (zyrën) dhe orarin e pedagogut përgjegjës. (Evidenca III, 1,3 Marrëveshje për organizimin e kohës vjetore të punës së stafit akademik)
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe	Ky departament në bashkëpunim me Qendrën e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanistike ka organizuar cikël leksionesh të




seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	hapura me studentët për prurjet e reja shkencore. Pamë të dokumentuar vetëm 1 prej tyre (Evidenca III, leksione të hapura) leksioni: prof.as E. Manovi nga Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë.			
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Programi i studimit të ciklit të parë bachelor në Gjuhë shqipe dhe Letërsi në Fakultetin e Shkencave Humane të Un. "I.Qemali", Vlorë nuk nuk parashikon praktika dhe punë laboratorike.			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Personeli akademik i DGjL mbështet nismat dhe punët përfaqësuese të studentëve duke qenë mbështetës dhe këshillues të tyre. Gjatë orëve të mësimi, veçanërisht të seminareve nxiten studentët për diskutime në grup, punë të pavarura e detyra kursi			
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Stafi akademik i DGjL ka krijuar një klimë të përshtatshme ndihme dhe inkurajimi për të mbështetur dhe asistuar shkencërisht punën e studentëve në këtë fushë studimi. Janë organizuar 2 konferenca ku pjesëmarrës janë studentë, njëra në kuadër të Fakultetit të Shkencave Humane dhe tjetra ndërkombëtare, çka u pohua edhe prej studentëve. (Evidenca, II,1,6) Studentët janë bërë pjesë dhe e tryezave të diskutimeve shkencore dhe promovimi veprash letrare. Ata marrin pjesë edhe në diskutimet e temave të kursit që diskutohen në oërt e mësimi.			
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Universiteti i Vlorës i ka mbështetur financiarisht botimet e studentëve. (Evidenca, III, 1, 8 Buletini i studenteve, botime të konferencave të studentëve).			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Ky Departament i ka ndërthurur format e mësimdhënies edhe me institucione të tjera bashkëpunuese si me ASA dhe Akademinë e Shkencave prej të cilave vinë profesorë dhe zhvillojnë mësim (nga pyetja estafit: prof.dr. V.Memishaj, prof.dr. Sh Sinani). Kjo nuk ka ndodhur me institucione të ngjashme jashtë vendit dhe nuk është bërë e mundur mobilitet studentësh në kuadër të Erasmus +. Po bëhen përpjekje të vazhdueshme për këtë dhe besojnë se do të finalizohet në të ardhmen e afërt.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


<b>Standardi III.8</b> <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Në rregulloren e këtij Departamenti (Evidenca, II,6 rregullorja e programit të studimit) është përcaktuar procedura e provimit të diplomës. Studentët e kanë të qartë që duhet të japin provim diploma në njërin nga drejtimet: Gjuhësi ose Letërsi. Kjo u është bërë e ditur edhe nga Sekretarisa Mësimore dhe Kordinatori për marrëdhëniet e punës me studentët. Për këtë është hartuar dhe programi i provimit të Diplomës, i cili iu vihet në dispozicion studentëve.  Në këtë departament, siç na u pohua nga pedagogët, të gjithë studentët i nënshtrohen provimit të Diplomës, sepse mesatarja gjatë tri viteve të Ciklit të parë nuk shkon mbi 9, prag që është vendosur për ata që mbrojnë temë diplome.  Nga studentët na u pohua që kanë mesatare të lartë disa prej tyre.
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion, programin e provimit të diplomës, literaturën e nevojshme, të cilat të fotokopjuar lihen në sekretari dhe janë të gatshëm për pyetje dhe konsultime për studentët, si dhe për t'i ndihmuar me literaturën e nevojshme.
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Përgjegjësi i Departamentit të GjL krijon komisionin prej pesë anëtarësh për të hartuar tezën e Provimit të Diplomës, e cila ndërtohet duke pasur parasysh formimin e studentëve gjatë 3 viteve të studimit, të shprehura këto edhe në Evidencë III, 11 Procedura e Diplomimit.  Teza ndërtohet me pyetje nga lende të formit bazë. Në RVB thuhet se pyetjet hartohen edhe në varësi nga pesha e ECTS të secilës disiplinë. Mendojmë se kjo nuk qëndron duke pasur parasysh se nuk ka diferenca në kreditet e lëndëve, pavarësisht peshës së tyre në formimin e studentëve.  Si në gjuhësi dhe në letërsi. Ajo përmban 3 pyetje (që na duket pak për të qenë përfaqësuese për gjithë atë sasi njohurish të marra). <b><i>GVJ sugjeron që teza e Provimit të Diplomës të hartohet mbi një bazë më të gjerë pyetjesh, të përzgjedhura me kujdes dhe që tregojnë formimin bazë të studentëve.</i></b>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Programi i provimit të diplomës iu vihet në dispozicion studentëve 2 muaj para që të kenë mundësi të njihen me të dhe të përgatiten, të gjejnë literaturën. Personeli akademik është gjithmone në gatishmëri për të ndihmuar studentët.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Ky kriter nuk përshtatet me këtë program studimi.

<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Prej vitit 2017-2019 nuk ka pasur asnjë student që ka mbrojtur temë diplome, sepse nuk i ka plotësuar kriteret, sipas stafit akademik (të cilin e pyetëm për këtë problem), pra kanë pasur notë mesatare më pshte se 9 (nëntë), kjo sipas rregullit të vendosur nga DGJL (shprehur dhe në evidencën III, 18 Vendim nr.9 dt, 26.01.2017)			
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në përfundim të provimit të diplomës, provim që zhvillohet me gojë, anëtarët e komisionit (jo më pak se 5) japin vlerësimin e tyre dhe nota përfundimtare është mesatatarja e këtyre vlerësimeve. Edhe pas kryerjes së mbrojtjes së diplomës vepohet po njësoj. Në të dy rastet studenti sipas Procedurës së Diplomimit, hartuar nga DGJL vlerësohet me notë.(Evidencë III, 11)			
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Kur studenti ka përmbushur të gjitha kërkesat akademike dhe financare nda UV, Sekretaria mësimore, plotëson dhe i pajis çdo student me diplomën dhe Suplementin (Evidencë II,9 Suplementi i diplomës) ku përshkruhen natyra e studimeve, niveli, përmbajtja dhe rezultatet e studentëve.			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në rastet kur studentit i duhet kopje e plotë e programit që ka zhvilluar, brenda 10 ditësh ai pajiset nga Sekretaria me të, pasi ka bërë një pagesë, tarifa e së cilës përcaktohet me vendim Senati.			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Sekretaria mësimore mban dhe ruan në mënyrë të përhershme: 1. Regjistrin e studentëve 2. Regjistrin e arritjeve akademike 3.Regjistrin e ruajtjes së suplementit dhe diplomës. Regjistrat (2 dhe 3) plotësohen me shkrim dore dhe në formë elektronike. Regjistri themeltar plotësohet vetëm me shkrim dore dhe nuk korrigjohet për asnjë arsye. Të gjitha këto janë të shprehur dhe në Statutin e UV, neni 78.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,  
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Mbështetur në nenin nr 21, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar dhe Ligjit për Arsimin e Lartë, 80/2015 referuar përshkrimit dhe detyrave të punës së personelit ndihmës akademik (shih evidence nr. II.3) dhe bisedës të zhvilluar gjatë vizitës online në institucion u konfirmua se, Drejtoria e Komunikimit dhe e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për sigurimin zbatimin e politikave të menaxhimit me efektivitet të burimeve njerëzore.</p> <p>Konkretisht, sektori i burimeve njerëzore merret me procedurat e rekrutimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesëshme</p> <p>2. Krijimin, plotësimin, përditësimin dhe përshkrimin e mangësive të e dosjes personale të personelit akademik dhe personelit ndihmës. 3. Përgatit shkresa të ndryshme, protokollon, raporton, zbaton vendimet e Senatit. 4. Plotëson regjistrin themeltar. 5 mban evidencën për ngarkesën e stafit mësimor për çdo semestër.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Bazuar në statutin e UV dhe kodin e punës Institucioni ka hartuar procedura e kriteret për rekrutimin e personelit. Parashikimet për staf të ri bëhen për çdo vit akademik nga departamenti.</p> <p>Çdo vit departamentet bëjnë përcaktimin e stafit akademik që përfshihet në programin e studimit, ngarkesën mësimore sipas semestrave dhe vjetore.</p> <p>Në bazë të ngarkesës mësimore departamenti bën planifikimin e pedagogëve si dhe i paraqet dekanatit nëse ka nevoja për rekrutim të stafit akademik dhe jo akademik të nevojshëm për realizimin e programit të studimit. Departamenti i përcjell kërkesat e tij në dekanat dhe me pas dekanati i përcjell në rektorat dhe pas rektoratit ato kalojnë për miratim në senat. Pasi miratohen në senat vendet e lira të punës shpallen në faqen e WEB-it të universitetit ku publikohen kriteret e përgjithshme dhe specifike për vendin e punës si dhe dokumentacioni që duhet të dorëzohet çdo kandidat, afatet kohore për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm si dhe tabela e pikëzimit.. Dorëzimi i dokumentacionit bëhet me rrugë postare.</p> <p>Gjatë takimit me stafin e zyrës së burimeve njerëzore të institucionit GVJ u njoh me procedurat e rekrutimit të stafit, me modelet e kontratave të punës për PAE, PAK. GVJ verifikoi me sondazh dosje të personelit akademik, kontratat e punës të stafit akademik efektiv dhe me kontratë.</p> <p>Dosja e stafit akademik përmban:</p>






	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Dokumentacionin që ka dorëzuar në momentin e aplikimit.</li> <li>2. Librezën e punës</li> <li>3. CV</li> <li>4. Listë notash, Diplomë, Diplomë gjuhe të huaj, dëshmi penaliteti, raport mjeko ligjor</li> <li>5. Fotokopje ID</li> <li>6. Procedurën e punësimit</li> <li>7. Vlerësimin e fazës së konkursit</li> </ol> <p>Rekrutimi i stafit kryhet sipas akteve rregullatore të miratuar nga UV (<i>statuti UV</i>) dhe kodit të punës. Në diskutimin me pedagogët u konstatua se ata njihen paraprakisht me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga lidhja e kontratës së punës.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Procedurat për rekrutim të personelit akademik i referohen kërkesave që paraqesin burimet njëzëre, duke nisur nga afatet kohore, kriteret e përgjithshme që duhet të plotësohen në dosje personale dhe kriteret e veçanta të deaprtamentit, mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, 80/2015, statutit dhe rregullores së brendshme. Kandidimi shpallet me konkurs. Bazuar në statutin e UV dhe kodin e punës Institucioni ka hartuar procedura e kritere për rekrutimin e personelit. Parashikimet për staf të ri bëhen për çdo vit akademik nga departamenti.</p> <p>Çdo vit departamentet bëjnë përcaktimin e stafit ademik që përfshihet në programin e studimit, ngarkesën mësimore sipas semestrave dhe vjetore.</p> <p>Në bazë të ngarkesës mësimore departamenti bën planifikimin e pedagogëve si dhe i paraqet dekanatit nëse ka nevoja për rekrutim të stafit akdemik dhe jo akademik të nevojshme për realizimin e programit të studimit. Departamenti i përcjell kërkesat e tij në dekanat dhe me pas dekanati i përcjell në rektorat dhe pas rektoratit ato kalojnë për miratim në senat. Pasi miratohen në senat vendet e lira të punës shpallen në faqen e WEB-it të universitetit ku publikohen kriteret e përgjithshme dhe specifike për vendin e punës si dhe dokumentacioni që duhet të dorëzoj çdo kandidat, afatet kohore për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm si dhe tabela e pikëzimit.. Dorëzimi i dokumnetacionit bëhet me rrugë postare.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Insitucioni ndjek përgjithësisht procedura korrekte duke nisur nga shpallje e njoftimit e deri në përfundim të procesit.</p> <p>Kriteret për rekrutimin e stafit akademik përcaktohen nga departamenti përgjegjës në bazë të nevojave specifike dhe i përcillen zyrës së burimeve njerëzore. Pas shpalljes së vëndit vakant, dekani ngre komision “ad hoc” që do të realizoj procedurën për rekrutimin e stafit akademik. Konkurimi kalon në dy faza:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vlerësim në bazë të dosjes</li> <li>2. Intervista gojore</li> </ol>

	<p>Kur një dosje skualifikohet, Drejtoria e Burimeve Njerëzore lajmëron kandidatin dhe ai brenda afatit kohor prej 5 ditë duhet të bëjë ankimim me shkrim nëse ka. Për çdo fazë vlerësimi pritet 5 ditë pas shpalljes së vlerësimit për ankimime nëse ka. Nëse nuk ka ankimim, mbyllet procedura e vlerësimit dhe vendimi i komisioni i përcillet dekanit.</p> <p>Nisur nga kriteret e veçanta, referuar njoftimit për personel akademik 2017 – 2018 sjellim në vëmendje mospërpëputhjen e kriterëve të veçanta. “Përvoja e gjatë insitucionale dhe pozitive dhe mesatarja mund të mos konsidërohet si kriter skualifikues. Tiulli “Profesor’ fitohet pas një përvoje të gjatë akademike dhe në kërkimin shkencor.</p> <p>Ne ndonjë rast rekrutimi i stafit të ri është bërë duke vlerësuar më tepër përvojen institucionale. Mendojmë se kjo nuk mund të vlerësohet me të njëjtat pikë sa kualifikimi akademik dhe shkencor, dhe aq më tepër të jetë kriter prioritar përzgjedhjeje, sepse përvoja institucionale ka në thelb menaxhimin, ndryshe nga përvoja akademike që ka në thelb përcjelljen e dijes.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	<p>Institucioni ka bërë përpjekje për të krijuar kushtet dhe hapësirat fizike dhe të zgjedh mundësi të përshtatshme për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p> <p>Sallat e leksioneve, ambienti i departamentit kishin infrastrukturë të përshtatshme (hapsira, kompjutera, tri salla të shfrytëzueshme të bibliotekës, hapësira e sekretarisë), tw cilat grupi ynw i pa tw gjitha gjatw vizitw online. Zyrat e stafit janë të paisura me tavolinë pune, kompjutera personal, printera, fotokopje etj si dhe materile kancelarie për kryerjen e procesit mësimor. Sekretaria ka ambiente të bollshme dhe bashkëkohore për pritjen e studentëve dhe kryerjen e detyrave të saj funksionale. Institucioni ka ambiente të dedikuara për arkivën.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e	Nga takimi me personelin akademik, angazhimi i institucionit për kualifikimin e vazhdueshëm, vihet edhe për stafin e punësuar me kohë të plotë është zgjedhur si formë kualifikimi, mentorimi.

mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Tipike janë trajnime afatshkurtra si dhe trajnime për hartim projektesh. Të gjitha këto forma janë të dobishme			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	<p>Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies duke filluar nga trajnimet afatshkurtra pjesëmrrje në konferencat shkencore, dhe botimi i një artikulli në një revistë shkencore gjatë një viti akademik. 1 artikull shkencor në vit, siç na u tha në takimin me stafin akademik i vendosur me vendim Senati, për anëtarët e stafit akademik na u duk një kriter shumë minimal për nxitjen e punës shkencore.</p> <p>Orientimi drejt shkëmbimit të eksperimentave ndërkombëtare me anë të bursave Erasmus do të ishte ndihmuese në kualifikimin e mëtejshëm profesional. Gjatë konsultimit me dokumentacionin në rang institucioni ishin hartuar disa projekte bashkpunimi me universitete jashtë kufijve, por stafi akademik i këtij programi studimi nuk ishte i përfshirë ende. <i>Referuar specifikës së këtij programi studimi, konsultimi me ASCAP për kurrikulën në bazë të kompetencave me të cilën punojnë sot AML dhe AMU do të ishte ndihmues.</i></p>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Institucioni bën përpjekje për tërheqjen e një stafi akademik të kualifikuar. Drejtoria e Burimeve Njerëzore me sektorët përkatës që janë përfshirë në këtë program studimi janë mbështetëse dhe të mjaftueshme. Ka një ndarje të përgjegjësive dhe të detyrave dhe njëkohësisht gatishmëri për realizimin e objektivave të caktuar.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/ëve të studimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve	Institucioni ka siguruar hapësira të mjaftueshme në mjedise të përshtatshme referuar numrit të sallave të leksioneve, numrit të sallave të seminareve, objektet bazike, dërrasa, tavolina, karrige (referuar aneksit, shtojca 41 informacion i drejtorisë së

mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	shërbimeve mbështetëse) Nisur dhe nga profili i programit dhe numri i studentëve, këto ambiente konsiderohen të përshtatshme			
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Institucioni ka investuar në aparatura të nevojshme për procesin e mësimdhënies. Referuar shtojcës nr.45, "Plani i masave për rritjen cilësisë së programit", një ndër rekomandimet thelbësore është përmirësimi i kushteve për studentët që zhvillojnë mësim në auditore ( mbetet për tu parë sesi do të përmirësohen këto kushte). Institucioni e konsideron efektive, gërshetimin e mësimdhënies tradicionale të kombinuar me metodën teknologjike. Zyra e departamentit dispononte tre videoprojektorë dhe një laptop.  <i>GVJ sugjeron Instalimi i programit moodle është efikas për procesin e mësimdhënies pasi do të ndihmonte që studenti të përditësohet në kohë reale me informacionet dhe materialet shitesë të hedhura nga pedagogu.</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Siç e referuam dhe më sipër në përshtatje dhe me natyrën e këtij program studimi departamenti kishte në dispozicion 2 lap top, tre video projektorë, printer.  <i>Departamenti paraqet mungesën e një laboratorit të fonetikës si pikë të dobët dhe mungesën një laboratorit informatike për të zhvilluar këtë lëndë në programin e Bachelorit.</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Megjithëse departamenti në raportin e vlerësimi të brendshëm përcjell informacionin se institucioni parashikon në buxhetin e tij ndërtimin e laboratoreve ende mbeten plane për t'u konkretizuar.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Institucioni parashikon praktika profesionale në ciklin e dytë të këtij programi studimi por nuk ka asnjë informacion se si do të realizohet ajo.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni ka tri godina bibliotke. Dy prej tyre punojnë me orar të reduktuar dhe njëra prej tyre me orar të zgjatur. Biblioteka ka mjedise me kushte komode dhe hapësira, tavolina, karrage, mjete fizike, wi – fi, ambiente që mund të shfrytëzohen lirshëm nga studentët dhe personeli akademik.
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	<p>Biblioteka është e pajisur me një numër të konsiderueshëm tekstesh në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Gjithsesi në raportin e brendshëm inventari është përshkruar në nivel institucional dhe jo në titujt që kanë lidhje me këtë program studimi.</p> <p>Gjatë vizitës u vu re një numër librash bazë të gjuhësisë të domsdoshëm për këtë program. <i>Ndoshta vetë institucioni duhet të përditësojë dhe pasurojë bibliotekën me tituj cilësorë e të rinj në ndihmë të studentëve, ose nga buxheti i programuar të ofrojë abonim në revista shkencore ose në biblioteka digjitale të univeriteteve të njohura që kanë të njëjtin program studimi , të cilat ofrojnë kundrejt pagesëse studime cilësore. Do të ndihmonte në grishjen e studentëve për një qasje me reflektive.</i></p> <p>Biblioteka, kishte përfutur kohët e fundit një fond librash, dhuratë nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Institucioni në bashkëpunim me MASR ka vënë në dispozicion librarinë online ULIBRARY. Aksesi në këtë librari është si për studentët dhe për personelin akademik.
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Institucioni ka bërë përpjekje për të investuar në infrastrukture. Të tri godinat kanë një numër të përcaktuar kompjuterash dhe pajisjesh. Interneti pa limit dhe shtimi i numrit të kompjuterave mund të ndihmonte studentët për ta bërë më të aksesueshëm gjithë informacionin që mund të merret në ULIBRARY ose informacione të tjera.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës,	Institucioni ka një plan për të pasuruar dhe përditësuar titujt e bibliotekës. Siç vihet re nga informacionet e RVB-së, ky

përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	plan lidhet me degët e tjera, por ka informacion të përgjithshëm lidhur me programin e letërsisë. Procedurat që ndiqen për pasurimin e fondit lidhur me këtë program janë të paqarta. Një pjesë e literaturës ishte e dhuruar,.			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Të tri ndërtesat që shërbejnë si bibliotekë qëndrojnë të hapura gjatë ditëve të javës në përputhje me procesin mësimor. Dy me orar 08- 16.00 dhe 08.- 20.00. Orari është i përshtatshëm për t'u shfrytëzuar nga studentët dhe nga personeli akademik			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Sistemi i menaxhimit administrojnë gjithë informacionin që lidhet me studentët. Ai disponon të tre llojet e regjistrave në formë shkresore dhe elektronike, dosjet e regjistrimit dhe diplomimit, dhe gjithë procesverbalet e rezultateve të studentëve. Të dhënat janë të hedhura në platformën UVMS duke ndihmuar studentët të kenë akses për një numër informacionesh.
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Siç cituam më sipër, institucioni ka një sistem të brendshëm menaxhimi elektronik i cili ende nuk ka aksesuar administrimin e të dhënave të stafit akademik dhe të personelit ndihmës. Gjithsesi sektori i burimeve njerëzore dhe i kurrikulave kryen të gjithë procedurat përkatëse për çdo punonjës të stafit akademik, personelit ndihmës, dhe disponon dosje personale me përditësimin e çdo informacioni.
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi UVMS siguron akses dhe është i dedikuar për të mundësuar shërbime për të gjithë personat e autorizuar që kanë një llogari personale të universitetit. Çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidenciale mer informacion për rezultatet e provimeve gjatë vitit akademik. Informacionet personale për stafin akademik administrohen në

	mënyrë konfidenciale nga strukturat e UV bazuar në Ligjin “Për mbrotjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”.			
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Secili pedagog mund të shpërndajë leksione dhe informacione shitesë në sistem UVMS për studentët e tij dhe ndërkohë ata mund të përcjellin dhe mendimin e tyre rreth leksionit duke ruajtur anonimat. Sistemi i menaxhimit të integruar UVMS shkon dhe në ndihmë të shkresave zyrtare që sekretaritë mësimore duhet t’u shpërndajnë studentëve			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Sistemi garanton monitorimin në kohë reale të aktiviteteve akademike, mundëson raporte individuale. Sipas nevojave sistemi ndihmon aksesimin e të dhënave, tarifivae afatet e e hedhjes së vlerësimeve.			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Faqja e Web e universitetit publikon të gjitha infromacionet zyrtare që lidhen me programin studimit duke duke ndjekur politikat institucionale.Të gjithë informacionet publikohen në të dyja gjuhët			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.6


**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga takimi u konfirmua se institucioni harton një raport financiar që pasqyron koston financiare mesatare për çdo student në nivel universitetit. Fillea e raportit nis nga njësia bazë që është departamenti,
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit	Në përputhje me strukturën e buxhetit, institucioni ndjek të dy fazat e hartimit të buxheti. Ai që vihet në dispozicion nga granti i pakushtëzuar i MASR -i, buxheti i shtetit dhe nga buxheti i i universitetit. Hartimi i buxhetiti nis nga njësia bazë e cila logarit të gjitha shpenzimet për këtë

<p>mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>program studimi dhe më tej koordinohen në nivel fakultetit dhe me strukturata e tjera. Drejtoria e Shërbimeve mbështetëse mbledh të dhënat nga shërbimet mbështetëse dhe paraqet planin për vitin në perspektive duke e paraqitur tek Rektorati, Senati akademik.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Universitetit “Ismail Qemali” i nënshtrohet auditit të jashtëm Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe MASR-së dhe auditit të brendshëm, një sektor më vete, bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe me vendimin e Senatit Akademik. Auditit i brendshëm harton një raport periodik financiar të të ardhurave nga tarifat apo burimet e tjera. Administratori e paraqet këtë raport në Senatin Akademik i cili miratohet dhe protokollohet.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni merr në analizë gjendjen financiare. Kjo bëhet jo vetëm për periudhën njëvjeçare por merr përsipër të kryejw krahasime dhe të bëjw ndërhyrje dhe reflektime për secilin program. Një studim mirëfilli i tregut të punës dhe pritshmërive do të ndihmonte dhe për një financim cilësor të këtij programi</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni garanton qëndrueshmëri financiare duke u nisur nga dy burimet financiare:</p> <p>Grantet e MASR -së</p> <p>Fondet që sigurohen nga të ardhurat e universitetit.</p> <p>Institucioni garanton qëndrueshmëri financiare. Pasqyra financiare hartohet brenda afateve të përcaktuara.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<b>X</b>



<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<b>X</b>






## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Procedurat e pranimit, vazhdimet të programit të studimit dhe diplomimit janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, udhëzimet e MASR-së dhe rregulloren e brendshme të institucionit, rregullores së departamentit duke filluar nga kriteri i mesatares në hyrje të programit, kohëzgjatjen zyrtare dhe shumën e krediteve në fund të programit.
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Referuar Statutit të universitetit i cili mbështet parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, garantohet transparencë për kriteret hyrëse dhe të gjitha procedurat e nevojshme për çdo student duke përfshirë dhe transferimin e krediteve. Kandidati ndjek të gjitha hapat që i nevojiten kundrejt afateve ligjore të përcaktuara. Numri i studentëve ndahet sipas zërave të përcaktuar më parë. Departamenti mbron studentët ndaj çdo lloj diskriminimi apo kriterëve të papërshtatshme.
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret e pranimit të studentëve dhe i transferimit të studimeve janë të paraqitura në Stauti në dhe rregulloren e studentëve. (evidencë V.I) Hap kyç është Ngritja e “Komisionit për ekuivalentimin e lëndëve” i cili në bashkëpunim me sekretarinë mësimore merret me të gjitha procedurat përkatëse.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	GVJ konstaton se institucioni miraton në Senatin Akademik të gjitha kriteret hyrëse në një program studimi. Referuar Udhëzimit të MASR-së, për kuota dhe kriteret, aplikantët duhet të kenë përfunduar AML-në në shtetin shqiptar apo jashtë, por më parë studentët që kanë përfunduar jashtë duhet të kryejnë ekuivalentimin e diplomës së fituar. Të gjitha këto informacione publikohen në faqen zyrtare të web-ti të universitetit dhe janë transparente.
<b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse	Të gjitha kriteret e pranimit në këtë program janë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë nr 80/2015 dhe VKM – së për përcaktimin e notës mesatare, Udhëzimin e MASR-





për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	së, kriteret e maturës shtetërore. Institucioni parashikon kuota të veçanta për studentët e trojeve dhe studentët e huaj nga programi Erasmus, por deri tani nuk kemi konstatuar asnjë rast të Erasmus.			
<b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Gjatë gjithë vitit institucioni harton dhe realizon takime promovuese nëpër shkollat e mesme të qytetit organizon ditet e hapura. Gjithsesi vendosja e mesatares për këtë program studimi ndikon edhe në numrin e nxënësve të cilët duan të ndjekin këtë program studimi. Institucioni mund të përditësojë edhe format e promovimit apo të motivimit të studentëve për të rriur numrine studentëve, në këtë program			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Gjatë takimit të zhvilluar dhe duke u konsultuar me dokumentacionin e paraqitur, në takimin me studentët dhe në rregulloren e miratuar të institucionit GVJ konstaton që institucioni përcjell dhe jep informacionin e nevojshëm për të ndihmuar studentin për përparimin akademik të tij.  Çdo individ që fiton statusin e studentit pajiset me adresën elektronike, kodin unik në sistem, akses për të parë kontrollin e vlerësimit për çdo lëndë dhe përditësismin me çdo informacion të nevojshëm. Rol të rëndësishëm në informim luan koordinatori i studentëve dhe përgjegjesi i departamentit të cilët ofrojnë informacion e nevojshëm për çdo shqetësim apo problematikë.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Siç parashikohet dhe në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/20155 institucioni aplikon procedurat për njohjen e krediteve dhe studimeve të mëparshme. Procedurat nisin pas kërkesës së studentit dhe plotësimit të formularit. informacionet gjenden në rregulloren e universitetit.(evidenca V.2)

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka një zyrë të veçantë informimi për studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve. Siç u konstatua të gjitha syllabuset kanë të detajuar të gjithë infomacionin duke nisur nga ngarkesa, temat mësimore, literatura për çdo temë, frekuentimi dhe procedurat e vlerësimit të dijeve. Çdo pedagog, në fund të sylabusit të çdo lënde ka vendosur edhe mënyrën dhe procedurat e vlerësimit të studentëve, të cilat iu bëhen me dije atyre që në fillim të procesit mësimor. Evidenca II.5</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Neni 68-të i Rregullores së Universitetit parashikon qartë kriteret dhe procedurat e punimit të diplomes për programin Bachelor Gjithë procedura është mbështetur në nenet dhe rregulloren përkatëse të miratuar nga Senati Akademik.</p> <p>Nga stafi akademik na u bë e ditur se për shkak të mestares së ulët pas 3-vjeçarit të gjithë studentët i nështrohen provimit të diplomës dhe nuk marrin temë diplome.</p> <p>Nga biseda me studentët na u bë me dije se ka prej tyre që kane mesatare të lartë. Mbetet detyrë e stafit akademik në të ardhmen që ta shohi me prioritet punën me studentët për hartimin enjë mikroteze diplome.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Spektori i Komunikimit është hallkë kryesore e Drejtorise së Burimeve Njerëzore që merret me organizimin e takimeve të hapura, bashkëpunimet me zyrat vendore arsimore për ti motivuar matruarantët që të zgjedhin këtë program studimi. Organizimi i panairëve është një mekanizëm tjetër i përzgjedhur për informim. Gjithsesi shqetësimi i shprehur dhe nga stafi akademik është numri i pakët i studentëve që ndjekin këtë program studimi, kjo për shumë arsye objektive. Ky shqetësim na u paraqit dhe nga Dekania e këtij Fakulteti. Politika e institucionit që ka në thelb promovimin dhe reklamimin e këtij programi, mund të pasurohet dhe me një vizitë nëpër gjimnaze të pedagoqeve dhe studentëve me të spikatur për t'i motivuar të zgjedhin këtë degë. Përfshirja e studentëve në programin Erasmus+ dhe mundësisë së ekperinces së një viti akademik ne një nga universitet me të cilat ka marrëveshje mund të joshte maturantet.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	<p>Institucioni përpiqet të informojë në mënyrë të hollësishme për strukturën dhe organizimin e programit të studimit. Faqja zyrtare web e universitetit përcjell të gjithë informacionin e nevojshëm për çdo student duke filluar nga rregullorja, organizimi dhe kohëzgjatja.</p> <p>Gjithashtu ka koordinim të punës së përgjegjës të departamentit dhe sekretarisë mësimore përkatëse me zyrën e studentit për takime informuese.</p> <p>Koordinatori i studentëve luan rol thelbësor në informimin e studentëve.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>GVJ konstaton se informacioni i nevojshëm për programin, procesin, rregulloren dhe aktivitetet ofrohet për studentët edhe në llogaritë e tyre elektronike, apo në format të printuar të vendosur në mjediset e hapura të universitetit.</p> <p>Siç referuam dhe më sipër studentit informohet me detaje dhe në syllabuset e lëndëve përkatëse</p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	<p>Alumni, Zyra e Këshillimit dhe stafi akademik janë si urë lidhëse për orientimin e tregut të punës.</p> <p>Gjithsesi, nuk ka ndonjë informacion konkret sesi kanë ndikuar në punësim e studentëve, apo ndonjë studim konkret për këte urë lidhëse.</p> <p>Orientimi profesional mund të ishte më i saktë, nëse do të kishin një studim të tregut të punës dhe më pas të ndërtohej bashkëpunimi me tyre.</p>
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<p>Sistemi UVMS krijon mundësi informacioni të hollësishëm për studentët. Që në momentin e parë ata pajisen me username/ fjalëkalim duke përfunduar dhe akses për leksionet dhe informacion shtesë informacionet. Gjithashtu rol në informimin e studentëve kanë dhe standat informuese në hapësirat e veçanta të universitetit.</p>
<b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë	<p>Sistemi i menaxhimit u ofron mundësi aksesimi shumë të lehtë studentëve duke u dhënë mundësi informacioni dhe në distancë. Faqja zyrtare e ëeb dhe llogaritë zyrtare në rrejtet</p>

lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	sociale të universiteti janë një nga format e përditësimit të informacionit në kohë reale.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	<p>Institucioni disponon të dhëna dhe statistika për numrin e studentëve, keto të dhëna janë të ruajtuara në të tri format hard copy të regjistrave dhe regjistrin në formë elektronike.</p> <p>Në sekretarinë mësimore janë të depozituara dokumentacionet e plota për numrin e studentëve të diplomuar për çdo program studimi. Sekretaria ka</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Regjistrin themeltar të studentëve</li> <li>- Regjistrin e lëshimit të diplomave</li> <li>- Regjistrin me të dhënat akademike (regjistri i notave)</li> </ul> <p>Në takimin me sekretarinë mësimore u informuam se regjistrat në formë të shkruar depozitohen me kohë të pacaktuar dhe arkivohen në arkivën e shtetit.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<p>Gjatë vizitës u konstatua që institucioni disponon të gjitha statistikat vjetore për studentet, si në kualifikimin dhe regjistrimin tërheqjet, largimet e mundshme e deri në cilësinë e diplomimit. Duke iu referuar numri të regjistrimit të studentëve vihet re, rënie e theksuar e regjistrimit të tyre. Numri i studentëve ka luhatur të konsiderueshme nga viti i tretë në vitin e parë. Konkretisht në vitin e parë të Bachelorit ka 9 studentë. Numri i ulët vjen dhe si rezultat i vendosjes së kriterit të mesatares së vendosur nga MASR-ja për programet e mësuesisë.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	<p>GVJ konstaton se institucioni ruan të gjitha informacionet e ecurisë së studentit nga momenti i regjistrimit deri në lëshimin e diplomave i cili realizohet në formën hard copy dhe në regjistrin elektronik. Bazuar në nenin 78 dhe 79-të</p>

	të Statutit të Unversitetit. Të dhwnat e studentëve sigurohen dhe ruhen në bazë të parimit të konfidencialitet.			
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Informacioni statistikor ruhet në sistemin UVMS dhe secili pre studentëve ka një dosje në këtë sistem por, studenti humb të drejtën e aksesimit menjëherë pasi përfundon programin e studimit. Referuar dhe praktikave të universiteteve europiane, emaili dhe fjalëkalimi janë përherë të aksesueshëm dhe një student mund të tërheqë elektronikisht listën e notave në sistemin elektronik kundrejt një pagese. Do të ishte pozitive që kjo praktikë të përfshihej edhe në këtë program studimi.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Referuar Udhezimit nr.5 të MASR-së, institucioni bën raport vjetor analitik për profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje të një programi. Sjellim në vëmendje që rritja e kufirit të mesatares ka ulur ndjeshëm numrin e pranimeve në këtë program në të mirë të cilësisë. Vlen të përmendet fakti që studentët dëshironin të vazhdonin ciklin e dytë të këtij programi por jo të punësoheshin si mësues. Ky informacion sjell nevojën e një studimi më të hollësishëm të tregut të punës dhe bashkëpunimi me shkollat, ku studentët po kryejnë praktikat profesionale për vazhdimin e bashkëpunimit dhe mundësisë së punësimit po në këto institucione arsimore. Do të ishte një masë ndihmuese dhe shërbente për një raport të plotë periodik për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve nga ky program studimi.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

### Standardi V.5



**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Aktet nënligjore të Ligjit të Arsimit të Lartë, statusi dhe rregullorja e miratuar kërkon përfshirjen e studentëve në strukturën e Senatit Akademik, Këshillit të Etikës, Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Institucioni parashikon angazhimin e studentëve me



Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tcl:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	përfaqësues të zgjedhur nga Këshilli i Studentëve në çdo instancë qeverisëse
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Gjatë bisedës me studentët u konfirmua se studentët përfaqësohen në proceset vendimarrëse në organet drejtuese përmes përfaqësuesve të zgjedhur prej tyre. Studentët e universitetit ishin pjese e grupit të punës për vlerësimin e brendshëm. Puna e tyre ishte fokusuar në gjurmimin studentëve të punësuar nga ky program studimit.
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Gjatë konsultimit me dokumentacionin u kostatua se institucioni ka në vëmendje përmirësimin e programit të studimit dhe ngarkesën akademike të studentëve. Studentët kanë të drejtë të transferojnë kredite duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike. Përgjegjësi departamentit, koodinatori i studentëve dhe sekretaria mësimore bashkëveprojnë për kryejën e këtij procesi, por më parë studenti duhet të plotësojë një formular aplikimi. Gjithashtu universiteti parashikon edhe një numër të caktuar të studentëve të trojeve dhe studentët që kanë përfunduar studimet e arsimit të mesëm të lartë jashtë kufijve por, me parë duhet të njohin këtë diplomë në institucionin përkatës.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Një instrument i përdorur gjerësisht sipas dokumenteve të paraqitura nga universiteti për përmirësimin e cilësisë është pyetësori me studentët. Pyetësori në evidencën (Evidenca..K. L) përkatëse pëmbante 14 pyetje. 12 të strukturuar dhe dy pyetje të hapura. Referuar evidencave të raportuara për pyetësin e vitit 2019 dhe bisedave të drejtpërdrejta me studentët u vu në dukje mospërputhje të pyetjeve që kishin përqindje më pozitive, "80 % e dhe pyetjeve që kishin përgjigje negative, po 80%. sipas rezultateve 80% e profesoreve të tyre shkojnë të përgatitur në mësim dhe përdorin metoda të efektshme, përqindja më e madhe e shqetësimit të studenteve i drejtohej vështirësive të përmbajtjes së leksioneve. Vlen të përmendet që pyetësori nuk është i profilizuar për këtë program studimit por në rang Universiteti. Koha në të cilën është kryer pyetësori nuk përputhej me atë çfarë është raportuar në RVB. Gjatë bisedës u raportua që pyetësori është hartuar në 2017, në RVB shkurt, 2020, ndërsa studentët informuan se pyetësori ishte realizuar në shtator. Institucioni i ka reflektuar rezultatet e pyetësorit në planin e masave për përmirësimin cilësisë në të cilin






	janë paraqitur rekomandimet, pikat e forta, pikat e dobëta. Evidenca III.1			
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentëve u ofrohet një proces transparent për vlerësimin e dijeve. Në hapësirën personale të sistemit elektronik, ata mund të japin mendimet e tyre rreth procesit të mësimin, gjithashtu kanë të drejtën e ankimimit për vlerësimin e dijës. Mënyra e vlerësimit të studentëve për çdo modul paraqitet në syllabusin përkatës Në rekomandimet e planit të masave për përmirësimin e cilësisë referuar sondazhit të vitit 2028-2019 i kushtohet vëmendje problematikës për arritjen e dakortësisë të vlerësimit dhe eliminim e presionit të notes por gjatë bisedës me studentët, nuk u shfaq në asnjë rast shqetësimi i paraqitur në raport.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### Standardi V.6

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	<p>Institucioni ka si pjesë të strukturës njësitë e posaçme që koordinohen në shërbimin dhe informimin e studentëve sic janë: Drejtoria e Edukimit, Sektori i Kurrikulave, Zyra e Shërbimit të Studentëve dhe Sektori i Këshillimit të Karrierës. Procedurat e ndjekura nga këto njësi janë në përputhje me Statutin dhe rregulloren e përcaktuar nga universiteti. I gjithë informacioni i nevojshëm shpërndahet tek studentët në bashkëveprim me Sekretarinë Mësimore dhe Koordinatorin e Studentëve.</p> <p>Në funksion të informimit të studentëve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Zyra e këshillimit akademik që organizon dhe sistemin e tutoratit për studentët e sapo regjistruar. Këshilltari akademik asiston studentët nga momenti i regjistrimit deri tek këshillimi për mundësinë e ndjekjes së programeve të tjera të studimit (master) apo për mundësitë e punësimit. Grupi i tutoratit krijohet nga student të viteve të larta dhe asiston studentët e vitit të parë në adaptimin me sistemin e mësimdhënies dhe akomodimin në UV.</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sekretaria mësimore; është e hapur cdo ditë për studentët dhe ofron shërbim akademik nga regjistrimi në diplomim.</li> <li>- Zyra e studentit: informon studentët për systemin e bursave, sistemin e akomodimit (konviktet)</li> </ul>								
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Sistemit të sektorëve të cituar më sipër u shtohet edhe zyra e Alumnit e cila konsiderohet si urë lidhëse midis universiteti dhe tregut të punës. Të gjitha këto hallka kanë në thelb jo vetëm informimin dhe këshillimin për programin e studimit por duhet të shërbejnë për orientimin e duhur profesional. Në tërësi kjo njësi, mund të jetë me aktive në ndihmën e ofruar për studentët për krijimin e një profili më të plotë dhe të qartë profesional, që do të ndihmonte në krijimin e shume mundësive për punësim.								
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Institucioni ofron mundësinë e këshillimit të karrierës në zyra e shërbime e cila ndihmon në zhvillimin social dhe kulturor të studentëve potencialw. Zyra e Këshillimit të Karrierës parimisht jep dhe orienton me informacion për karrirën profesionale por duhet sjellë në vëmendje, që pothuajse të gjithë studentë ciklin e parë të studimeve kishin dëshirë të vazhdonin në Mësuesi të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë.								
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Institucioni ka një zyrë Këshillimi Karriere e cila bashkëpunon dhe koordinon veprimet me hallkat e tjera administrative në rektorat por duhet sjellë në vëmendje mospërputhja e informacionit të listuar në shtojcën gjurmë i studentëve që kanë përfunduar programin ka listuar 19 studentë) dhe bisedes që u zhvillua me studentët. Zyra e Alumnit duhet të ketë si pjesë të përshkrimit të punës jo vetëm listimin e studentëve që kanë përfunduar këtë program studimi por edhe këshillimin e studentëve gjatë karrierës së tyre, arritjet dhe pengesat duke i dhënë mundësi krijimi të Alumnit(të këtij programi në vecanti).								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<b>X</b>

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR



<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Institucioni haron politika për sigurimin e brendshëm të cilësisë së institucionit në përputhje në standardet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe si detyrim i Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015. Institucioni ka miratuar një grup pune të përheshëm në nivel institucional, i cili mbështet punën e tij në Planin strategjik dhe në Statutin e institucionit</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni ka ngritur një Njësi të Përhershme të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë duke e përshtatur si sektor në Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe të Projekteve. Çdo njësi bazë ka një komision të përhershëm cilësie në të cilin ashtu si në çdo organ qeverisës së universiteti ka përfaqësues të studentëve të zgjedhur nga Keshilli i Studentëve. Si mekanizëm i monitorimit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përfshihen edhe zv/dekanët që mbulojnë arritjet akademike dhe përpilimi i raporteve vjetore që fillojnë nga nivel departamenti</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Institucioni ka aplikuar pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë të Arsimit të Lartë për Akreditimin Institucional dhe të programeve të studimit. UV ka përbushur detyrimin ligjor të akreditimit institucional për një periudhë 3 vjeçar në vitin 2017 dhe po punon për akreditimin e programeve të studimit. Institucioni i është nënshtruar dhe sondazhit kombëtar të studentëve. Referuar (evidencës VII) Institucioni ka ndjekur të gjitha procedurat e kërkuara të lidhura me këtë proces.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Institucioni përpaket të hartojë një politikë të qartë të sigurimit të brendshëm të cilësisë Në Statutin e universitetit përkrahur procedurat që ndiqen duke nisur nga hartimi i rregullores, hartimin e pyetësoreve në funksion të komisioneve dhe autoriteteve dhe studime të gjurmimit të ecurisë së studentëve. <i>GVJ inkurajon përpilimin e rregullores së NJSBC.</i> Konkretisht departamenti i Gjuhës dhe Lletërsisë procedurat për përmirësim dhe ndryshim për cikline parë dhe të dytë ia paraqet Drejtorisë</p>

	së Edukimit e cila e përcjell për shqyrtim dhe vendim Senatit Akademik. (Evidenca II.1)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi VI.2


**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Njësia e posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve në Universitetin "Ismail Qemali" përbëhet nga Drejtoria e edukimit për cikline parë e të dyte, Sektori i kurrikulave dhe shërbimit të studentëve, zv/dekanët që merren me arritjet akademike, dhe NJSCVB. Në takimin me personel të Drejtorisë së Edukimit, GVJ u njoh me aspekte praktike të zyrës së kurrikulave pranë kësaj drejtorie.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Institucioni përdor mekanizma e procese të dokumentuara si raporte periodike vjetore, ndërsa Drejtoria e Edukimit ndjek procedurat dhe vlerëson mundësinë e riorganizimit të programeve. Sipas RVB hartohen pyetësorë i përpara çdo sezoni provimesh duke ruajtur anonimatën e studentëve dhe diskutimi i tyre duke e videntuar pikat e dobëta dhe pikat e forta, hartimi i një plani masash për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë në evidencat e paraqitura.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Metodologjia e përdorur për pyetësorët e studentëve është sasiorë dhe është miratuar me vendim të Senatit Akademik Sipas evidenca K.L.(metodologjia) pyetësori ka gjithsej 14 pyetje të strukturuar dhe dy të hapura. Në pyetësor janë përfshirë edhe studentët që kanë frekuentuar edhe vetëm një lëndë. Gjithsesi mungesa e një pyetësori të profilizuar për programin e letërsisë është një hapësirë boshe e cila do të ndihmonete më shumë për vlerësimin objektiv të arritjeve, përtishmëritë dhe mundësitë e plotësisht të përditësimit të këtij programi.

<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Referuar procedurës së Analizës së Vlerësimit të pyetësoreve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies, raporti i pyetësoreve me rekomandimet dhe reflektimeve u përcillen strukturave përgjegjëse në universitet. Dokumentimi analitik i rezultateve realizohet nga NJSBC. NJSBC përpilon gjithashtu projektpropozimet dhe rekomandimet mbështetur në analizën e pyetësorëve dhe formularëve të performancës. Raporti i dërgohet njësisë kryesore e cila ia përcjell departamenteve për konsultim dhe reflektim në funksion të përmirësimit të programit të studimit. Sic është: Raporti dhe projekt propozimet për rritjen e cilësisë së programeve të studimit zuar në rezultatet e pyetësorit mbi cilësinë e mësimdhënies për çdo program studimi.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësisve dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Njësitë kryesore bazë, departamentet diskutojnë dhe reflektojnë mbi këto raporte Në planin e masave të përmirësimit të cilësisë janë paraqitur pikat e dobëta dhe pikat e forta, njëkohësisht dhe rekomandimet.(Evidenca III.1)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<b>X</b>	

<p><b>Standardi VI.3</b> <b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Referuar Standartit VI.1 të Universitetit, Rektorati ka ngritur pranë Drejtorisë së Edukimit, sektorin e Njësisë së Brendshme të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional. Hallkë e sigurimit të cilësiës është dhe bashkëpunim me zv/dekanët. Më rëndësi është edhe parashikimi për ngritjen e Komisionit të Sigurisë së Cilësisë së Brendshme. Puna e këtij komisioni do përqëndrohej në monitorimin e syllabuseve të programit të studimit dhe raportimin në departament. Raporti mund të ndihmojë në reflektimin dhe në rritjen e cilësisë së syllabuseve.</p>





<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Në mungesë të Komisionit të Cilësisë i cili do të duhej të monitoronte punën sesi janë ndërtuar syllabuset, ngarkesën, shpërndarjen e krediteve dhe mbarëvajtjes së formave të vlerësimit, institucioni përdor tri metoda për kryerjen e procesit të vetëvlerësimit, duke nisur nga raporti vjetor, pyetësorët me studentët dhe ndryshimet e programeve të mbështura në VKM-ë dhe udhëzimin përkatës.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Institucioni përdor si metodë të drejtpërdrejtë të vlerësimit të cilësisë anketimin e studentëve. Sipas RVB -së kjo procedure është kryer për dy vite rresht ndërsa studentët konfirmojnë pjesmarrjen vetëm, në një anketim i cili është kryer në nivel fakulteti. Duhet të sjellim në vëmendje mungesën një modeli specifik pyetësori për programin e gjuhës dhe letërsisë shipe, lidhur me ndërtimin e syllabuseve, pasurimin të tyre, burimet që shfrytëzoheshin, motivimet, përfshirjen e studentëve në programin Erasmus+, motivimin për të vazhduar ciklin e dytë në degën e Mësuesisë, dhe jo në degë të tjera.</p> <p>Gjithashtu përgjegjësi i departamentit përpiqet të kryejë vëzhgime të procesit mësimor gjatë gjithë vitit. Si hallkë e vlerësimit të cilisë së institucionit përpiqet të përfshijë dhe studentët që kanë përfunduar këtë program studimi (Alumni). Institucioni vlerëson në mënyrë periodike performancën e stafit akademik. Evidenca VI.5</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

**Standardi VI.4**


**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka të përfshirë në Statut në Rregullore dhe në Planin strategjik për sigurinë e clësisë së brendshme edhe politikat për përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. <i>Megjithëse në përbërje të NJSBC nuk ka student apo përfaqësues të jashtëm</i> Përfshirja në projekte që janë të fokusura në sigurimin e cilësisë së brendshme, trajnim e për përshtatjen e programeve me tregun e punës. Gjithe informacionet e paraqitura nga departamenti janë premtuese por janë ende në fazën e dokumenteve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Ngritja e Komisioni të Sigurimit të Cilësisë ende nuk është finalizuar dhe rrjedhimisht, nuk ka krijuar një përvojë të vetën monitorimi apo reflektimi rreth programit. Pikë pozitive është integrimi i studentëve të zgjedhur nga Këshilli i Studentëve, në këto struktura duke u shpërndarë detyra dhe përgjegjësi. Megjithatë duhet të vërejmë se studenti që ishte pjesë e GVB nuk e kishte shumë të qartë detyrën në këtë komision ( kishte shkuar në Drejtorinë arsim për të marrë nr e studentëve të punësuar, por ne verejtëm se kishte një korrespondencë shkresore me titullaret e inst.per këtë evidenca.1.4)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>NJSBC funksionon në nivel institucioni dhe koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në të gjitha njësitë kryesore. Në mungesë të një zyre të sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel fakulteti, ky funksion është realizuar nga dekanati i cili bashkëpunon dhe shkëmben informacion me NJSBC për problemet e cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Vlerësimi i sigurisë dhe i cilësisë kërkon dhe bashkëpunimin dhe përfshirjen e gjithë aktorëve të departmentit dhe personelit ndihmës akademik që nga drejtoria e kurrikulës, drejtoria e edukimit. Sekretaritetë mësimore kanë statistika të plota dhe të detajura për arritjet e çdo studenti në këtë program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo</p>	<p>Pjesë përbërse e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm përveç stafit akademik të përzgjedhur konsiderohet si pike pozitive integrimi i studentëve duke shmangur çdo lloj diskriminimi në</p>


pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	formë apo në përmabajtje. Studentëve u garantohej anonimatit dhe liria e mendimit në çdo pyetësor.  Po kështu në analizën e pyetësorëve është parë gjithmonë me kujdes moscënimi i figurës së pedagogut.			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Përveç integritetit të grupit të vlerësimit të brendshëm, universiteti përpiqet të përfshijë dhe faktorë të tjerë në proceset e vlerësimit për të siguruar mundësinë e më shumë opinionëve për të përmirësuar cilësinë programve.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë në përgjithësi transparente, dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare on line të universitetit. Statuti, Rregulloret, vendime të senatit etj. gjenden të publikuara në këtë faqe të hapur për publikun e interesuar. Informacionet përcillen dhe në formë shkresore në njësinë kryesore dhe njësitë bazë ku janë të aksesueshme nga personeli akademik, ndihmës akademik dhe studentët.  Do të ishte pozitive që për pikat e dobëta dhe rekomandimet të dikutoheshin me grupet e interesit duke dhënë feedbackun dhe kjo do të ndihmonte në transparencën e plotë dhe në mundësinë e përmirësimit të mëtejshëm të grupit të vlerësimit të brendshëm.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.531, Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë, institucioni përpilon raportin dhe analizën e pyetësorve. Rezultatet e vlerësimit të brendshëm janë transparente. Ne raport është respektuar etika akademike, të dhënat janë përcjellë pa




	shmangur informacione të rëndësishme dhe në bazë të ligjit 48/ 2012 janë repektuar parimet e konfidencialitetit.			
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm ka paraqitur pikat e forta dhe pikat e dobëta të shoqëruara dhe me rekomandimet përkatëse duke u mbështetur dhe në rezultatet e pyetësorëve të cilët gjithsesi, nuk janë të specifikuar për këtë program studimi. Përsa i përket rekomandimeve mbeten të përgjithshme në formë.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Në kuadër të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë , institucioni ka hartuar dhe diskutuar planin e përmirësimit të sigurimit të cilësisë ku ka evidentuar pikat e forta dhe të dobëta. Gjithsesi në planin e përmirësimit është konsideruar ngritja një grupi pune, por mbetet i paqartë se çfarë metode do të ndjekë për përmirësimin e pyetësorëve.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni organizon veprimtari periodike me qëllimin e informimit dhe ndërgjegjësimin e studentëve me anë të seminareve dhe trajnimeve informuese. Gjithsesi konkretizimi dhe jo vetëm planifikim, i Komisionit të Përhershëm të Cilësisë do të ndihmonte në qartësimin formës së bashkëpunimit të satfit akademik dhe studentëve.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	



# **Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Gjuhë Shqipe dhe Letërsi” i Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Ismail Qemali Vlorë”**

## **Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Është një program studimi bashkëkohor, i cili i jep mundësi studentit për vijimin e natyrshëm në nivele më të larta studimi si edhe për mobilitet.
2. Programi i studimit ka në përbërje një staf akademik me kualifikimin e duhur shkencor ku ndërthurret përvoja e stafit më me përvojë me atë më të ri.
3. Ekziston një klimë bashkëpunimi midis njësisë bazë dhe organeve drejtuese të fakultetit dhe të universitetit.
4. Ka një staf mbështetës të përkushtuar dhe në dispozicion të studentit dhe pedagogut.
5. Ky program studimi zhvillohet në një infrastrukturë shumë të mirë, të gjerë dhe të pajisur me mjete mësimore bashkëkohore.

## **Pika të dobta:**

1. Në këtë program studimi (si në gjithë U. “I. Qemali”) ka një numri të vogël studentësh, i cili bie nga viti në vit.
2. Mungon një studim i mirefillte i tregut të punës për te njohur nevojat reale të programit të studimit si dhe mungon një databazë për të diplomuarit.
3. Vihet re një ngarkesë e madhe orësh javore në auditor për çdo lëndë (4leks+2 sem), gjë që dëmton cilësinë e mësimdhënies
4. Ka një numër të njëjës ECTS si për silabuset e lëndëve të formimit bazë, të integruara dhe plotësuese.
5. Departamenti paraqet mungesën e një laboratorit të fonetikës për të zhvilluar këtë lëndë në programin e Bachelorit.
6. Nuk ishte praktikë udhëheqja e temave të diplomave në finalizim të këtij program studimi, por provim diplome me argumentin se ka studentë që nuk e plotësojnë kriterin e notës. Takimi me studentët provoi se kishte prej tyre që kishin dëshirën, por dhe mesataren e nevojshme.

## **Rekomandime:**

1. GVJ rekomandon rishikimin e syllabuseve, përditësimin, saktësimin dhe formatimin e tyre në përputhje të plotë me kërkesat e VKM nr.41 datë 24.01.2018 .
2. GVJ rekomandon krijimin e një laboratorit të fonetikës për të zhvilluar këtë lëndë në programin e Bachelorit
3. Duhet të vendoset një raport i drejtë i krediteve midis lëndëve të formimit bazë, të integruara dhe plotësuese. Të ulet ngarkesa në auditor si për studentët dhe për pedagogët.
4. Rekomandohet të shtohet numri i anëtarëve të stafit akademik që përfshihen në trajnime dhe projekte si Erasmus+ etj.
5. Rekomandohet të rritet aktiviteti shkencor i stafit akademik. Kjo jo vetëm me pjesëmarrje në aktivitete shkencore brenda këtij Universiteti, por dhe me artikuj shkencorë e

pjesëmarrje në konferenca brenda e jashtë vendit.(1 artikull në vit, i miratuar nga Senati, është i pamjaftueshëm).

6. GVJ rekomandon përditësimin dhe pasurimin e bibliotekës me më shumë tituj cilësorë e të rinj në ndihmë të studentëve, të ofrojë abonim në revista shkencore dhe në biblioteka digjitale.
7. Rekomandojmë që studimi i tregut të punës dhe punësimi i studentëve të jetë periodik dhe bazuar mbi një databazë, jo spontan.
8. Rekomandohet që vlerësimi i cilësisë të bëhet pjesë e punës së përditshme të të gjithë aktorëve: pedagogë, studentë e staf ndihmës. Kjo do të rrisë kulturën e matjes së cilësisë në mënyrë periodike.

### **Conclusions of the Evaluation for the first cycle study program Bachelor "Albanian Language and Literature" of the Higher Education Institution, University "Ismail Qemali", Vlorë.**

#### **Strengths and Affirmations:**

1. It is a contemporary study program, which gives the student opportunities for natural attendance at higher levels of study as well as for mobility.
2. The study program is developed by an academic staff with the appropriate scientific qualification where the experience of the most experienced staff is intertwined with that of the youngest.
3. A climate of cooperation prevails between the basic unit and the governing bodies of the faculty and the university.
4. There is a supportive and dedicated staff available to the student and lecturer.
5. This study program takes place in a very good, extensive infrastructure and equipped with modern teaching tools.



#### **Weaknesses:**

1. This study program (as in the whole "Ismail Qemali" University) is attended by a small number of students, which is decreasing from year to year.
2. There is no proper labor market study to know the real needs of students graduating from this study program and there is also a lack of a database for graduates.
3. There is a large load of weekly hours in the auditorium for each subject (4lex + 2 sem), a situation which affects the quality of teaching.
4. It is an equal number of ECTS as for syllabi of basic, integrated and complementary subjects.
5. In the department there is a lack of a phonetics laboratory for the development of this subject in the Bachelor program.
6. At the end of this study program, the practice of leading the diploma thesis is not followed, but in all cases the program is finalized with a diploma exam. This with the argument that there are students who do not meet the grading criteria. However, the meeting with the

students proved that there were some of them who had not only the desire, but also the average needed to finalize this study program with the defense of a diploma thesis.

**Recommendation:**

1. The External Evaluation Group recommends reviewing the syllabi, updating, correcting and formatting them in full compliance with the requirements of DCM no. 41 dated 24.01.2018.
2. The External Evaluation Group recommends the establishment of a phonetics laboratory to develop this subject in the Bachelor program.
3. A fair credit ratio should be established between basic, integrated and complementary courses. In addition, the External Evaluation Group recommends reducing the workload in the auditorium for both students and faculty.
4. The External Evaluation Group recommends the involvement of a larger number of academic staff members in trainings and projects such as Erasmus + etc.
5. The External Evaluation Group recommends expanding the scientific activity of the academic staff not only by participating in scientific activities within this University, but also by publishing scientific articles and participating in conferences inside and outside the country. (1 scientific article per year, approved by the Senate, is inconsiderable).
6. The External Evaluation Group recommends enriching the library with more quality titles and new publications. It also recommends subscribing to both online scientific journals and physical copies. The digital library would be a great help for the academic support staff, but especially for the students.
7. The External Evaluation Group recommends the labor market study for the employment of students periodically and based on a database. This should not be spontaneous.
8. The External Evaluation Group recommends that quality assessment become part of the daily work of all actors: faculty, students and support staff. This will promote the culture of periodic quality measurement.



FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>